



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT  
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 134  
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 56  
Data/Datum/Date: 24/01/2014  
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

DATË/A:	24/01/2014
REFERENC-Ë:	DZHPR-AM 03-03/2014
PËR/ZA/TO:	Blerand Stavileci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR
NGA/OD/FROM:	Shqipe Dema, Drejtore e Departamentit të Zhvillimit të Politikave Rurale/Kryetare e Autoritetit Menaxhues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Programi për Zhvillim Rural 2014

I nderuar Ministër,

Programi për zhvillim Rural për vitin 2014 është i bazuar ne programi e ri shtatëvjeçar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-20 i cili është përgatitura duke u bazuar ne: Raportin e vlerësimit afatmesëm të PBZHR 2007-13, analiza SWOT me të gjithë partneret social, analizën e sektorit të blegtorisë, pemëve- perimeve dhe drithërave, dhe analiza e diversifikimin të ekonomive rurale, si dhe raporti i ex-ante (vlerësimit paraprak).

Përgatitja e programit është udhëhequr nga Autoritet Menaxhues ne konsultim të ngushtë me partneret social ; OJQ, përfaqësues të shoqatave të fermerëve, agro- industrisë dhe ekspert nga komunitet i donatorëve.

Duke u bazuar ne dokumentet e lartpërmendura, prioritet e identifikuar dhe buxhetin aktual ne dispozicion, Autoritet Menaxhues për vitin 2014 ka përgatite këto masa:

#### PROGRAMI I ZHVILLIMIT RURAL 2014


MASAT	BUXHETI/€
MASA 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	5,750,000
MASA 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë	3,000,000
MASA302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	850,000
*MASA 303 - Përgatitja dhe zbatimi/ implementimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja LEADER	150,000

MASA: Skema për ujitjen e tokave bujqësore	1,500,000
TOTAL BUXHETI PER VITIN 2014	11,250,000

\*thirrja për aplikim për MASA 303 - Përgatitja dhe zbatimi/ implementimi i strategjive zhvillimore lokale - qasja LEADER do të bëhet në prill

Me që se programi duhet të implementohet konform akteve ligjit që dalin nga ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Autoritet Menaxhues ju lutet që të aprovi programin e propozuar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2014 në mënyrë që të paraprij finalizimit të rregullores dhe udhëzuesit për implementim.

**Aprovoj**



**Blerand Stavileci, Ministër i Ministrisë së  
Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

24.01.2014

**Data**



## M101:INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE

### 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, , dt. 01 korrik 2009
- Ligji Nr. 03/L-029 Për inspektionin bujqësorë, 13 dhjetor 2008;
- Ligji Nr. 03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve dt. 27 nëntor 2008;
- Ligji Nr. 02/L-26 Për tokën bujqësore,dt. 23 qershor 2006;
- Ligji Nr. 02/L-9 Për ujitjen e tokave bujqësore,dt. 25 nëntor 2005;
- Ligji Nr. 2004/13 Për materialin fidanor,dt. 28 maj 2004;
- Ligji Nr. 2003/5 Për farërat,dt. 15 prill 2003;
- Ligji Nr. 2005/47 Për verërat,dt. 14 tetor 2005;
- Ligji Nr. 2004/21 Për Veterinarinë,dt. 30 korrik 2004;
- Ligji Nr. 04/L-191 Për Blegtorin,dt. 28 qershor 2013
- Ligji Nr. 2005/02-L10, Për Përkujdesjen ndaj kafshëve,dt. më 9 maj 2005;
- Ligji Nr. 03/L-024 Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis,dt. 19 mars 2009;
- Ligji Nr. 03-L-025 Për mbrojtjen e mjedisit,dt. 19.03.2009
- Ligji Nr. 04/L-074 Për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim Rural,dt. 19 Mars 2012.

### 2. ARSYESHMËRIA

Spektori i bujqësisë në Kosovë luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e mundësive në punësim dhe në krijimin e të ardhurave. Në vitin 2012, 25% e punësimit dhe 14.1% e GDP-së vinte nga ky sektor. Analiza SWOT për bujqësinë e Kosovës thekson zëvendësimin e importit dhe qasjen e lirë në tregun e BE-së, si mundësi të rëndësishme për përmirësimin e të ardhurave kombëtare dhe individuale nga bujqësia në Kosovë. Megjithatë, ky potencial do të realizohet vetëm nëse fermat janë të afta të konkurrojnë me çmimet e tregut në BE.

Analiza e aftësisë konkurruese e bujqësisë së Kosovës tregon që aktualisht vetëm një pjesë shumë e vogël e fermave mund të konkurrojnë në tregun e BE-së dhe atë ndërkombëtar. Shkaktarët kryesor strukturor të kësaj aftësie të ulët konkurruese janë madhësia e vogël e shumicës së bizneseve bujqësore, fragmentimi i tokës së tyre, ndërtesat dhe pajisjet e vjetra, mungesa e financave për investime dhe niveli i ulët i njohurive lidhur me teknologjinë bashkëkohore të prodhimit. Veç kësaj, shumica e fermave nuk përmbushin standardet e BE-së për siguri dhe higjienë të ushqimit, për mirëqenie të kafshëve dhe mbrojtje të mjedisit.

Një pjesë e madhe e fermave janë aq të vogla sa pothuaj i tërë prodhimi i tyre konsumohet drejtpërdrejt nga familja në fermë. Kështu që, ka nevojë të ketë përqendrim në përkrahjen e investimeve në asetet fizike të fermave që kanë orientim komercial dhe janë në gjendje të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme.

Duke marrë parasysh faktin se shumica e fermave janë shumë të vogla, duket e arsyeshme që të nxitet edhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet bujqve në formën e bashkëpunimit të prodhuesve, i cili mund të ndërtojë bazën për organizatat e mëvonshme prodhuese, ose shoqatat e prodhuesve por edhe për integrimin vertikal të bujqve,për shembull në hallkat e tregut përmes kontratave të furnizimit.

Sipas të dhënave në dispozicion struktura e moshës së pronarëve të fermave është shumë e pafavorshme – mbi 50% janë mbi 65 vjeç. Kështu që do të nxiten Fermeret e rinj të moshës prej 18 deri 40 vjeç, të cilët përfaqësojnë bazën për një sektor bashkëkohor dhe inovativ bujqësor.

Në bazë të këtij shqyrtimi, por edhe të përparësisë krahasuese të cilën Kosova e ka në disa sektorë, kontributit të sektorëve në ekonominë e fermave dhe nevojës së sektorëve për përafrim me standardet e BE-së, masa do të përqendrohet në përkrahjen e investimeve në këta sektorë; pemë, perime (përfshirë patatet), qumësht, mish, drithëra, rrush dhe vezë.

#### *SEKTORII I PEMËVE*

Si rezultat i kushteve të mira të kultivimit, në shumë rajone të Kosovës, prodhimi i pemëve në Kosovë, ka një traditë të gjatë. Mollët dhe kumbullat përbëjnë pjesën më të madhe sa i përket sipërfaqes prodhuese dhe sasisë, kryesisht të kultivuar në kopshtet e shtëpive dhe me kultivim ekstensiv. Viteve të fundit ka filluar prodhimi më intensiv në pemishtet me mollë, dardha, vishnje dhe kumbulla ndërsa prodhimi i pemëve manore ka filluar te rreth 200 prodhues gjysmë-komercial dhe 50 prodhues komercial me rendimente të pranueshme (20-50t /ha). Sektori i kumbullave është edhe më i fragmentuar me vetëm 100 prodhues gjysmë-komercial dhe komercial duke arritur rendimente prej 12-20 t/ha. Prodhimi vendor nuk e arrin vetëmjaftueshmërinë gjë që le hapësirë për zgjerimin e sipërfaqeve me prodhim intensiv të pemëve. Momentalisht, prodhuesit e pemëve ballafaqohen me disa probleme si pemishtet e vjetra dhe varietetet me cilësi të dobët, mungesa e mundësive për ujitje, mungesa e depove për ruajtjen e pemëve, pajisjet e dobëta për klasifikim dhe paketim për tregtimin e pemëve. Tregu kërkon sasi të vazhdueshme dhe homogjene të pemëve me cilësi të lartë. Kështu që, kjo masë kryesisht synon intensifikimin e prodhimit të pemëve në një sipërfaqe më të gjerë dhe arritjen e standardeve të cilësisë së lartë të produkteve. Fermat me rentabilitet potencial ekonomik me një prodhim të orientuar kah tregu, janë përfitues që synohen.

Nën-masa do të përqendrohet në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit duke përkrahur ngritjen/rehabilitimin e sipërfaqeve të reja me pemishte, modernizimin e pajisjeve për kultivim, sistemet për ujitje që kursejnë ujë dhe makinerinë e përdorur në fermë për të përmirësuar efikasitetin në fermë si dhe përmirësimin e përgjithshëm të standardeve. Do të përkrahët ndërtimi dhe përmirësimi i pronës së paluajtshme për të mundësuar aktivitetet e pas-vjeljes. Do të përkrahen edhe investimet e mëtejme në shfrytëzimin e qëndrueshëm të energjisë.

#### *SEKTORII I PERIMEVE (përfshirë patatet)*

Sektori i perimtarisë, përkundër shtrirjes së vogël, është më premtuesi në Kosovë pasi që ka kushte të mira kultivimi dhe mund të sigurojë rritje të mirë të vlerës së shtuar. Sektori i perimtarisë përbëhet vetëm nga rreth 1,500 kultivues komercial dhe një numër i madh i kultivuesve gjysmë-komercial dhe ekzistencial.

Sektori dominohet nga fermat e vogla private me një sipërfaqe mesatare prej 0.80 ha, me produktivitet dhe rendimente të ulëta si dhe zinxhirë joefikas të furnizimit, me shpenzime të larta për grumbullim dhe logjistikë. Tregtimi i perimeve të freskëta shpesh bëhet pa paketim të përshtatshëm dhe pa klasifikim të prodhimeve.

Për të arritur përmirësime të konsiderueshme dhe kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe shtuar të hyrat dhe investimet në të dy nivelet, në prodhim dhe në përpunim, është e domosdoshme që të shfrytëzohen mundësitë ekzistuese dhe mbulohen boshllëqet dominuese



teknologjike që ende kufizojnë rritjen e sektorit. Veç kësaj, tregu kërkon furnizim me perime më të pavarur nga prodhimi stinor gjatë tërë vitit.

Kështu që në kuadër të kësaj mase, përkrahja do të sigurohet për (ri)ndërtimin e serrave permanente për prodhimin e perimeve dhe modernizimin e pajisjeve të kultivimit (p.sh. për mbrojtje nga breshëri) dhe makinerinë e përdorur në fermë për të përmirësuar efikasitetin në fermë si dhe përmirësimin e përgjithshëm të standardeve. Ndërtimi dhe përmirësimi i pronës së paluajtshme do të përkrahet për të mundësuar aktivitetet pas vjeljes. Do të përkrahen investimet e mëtejme për shfrytëzim të qëndrueshëm të energjisë.

## SEKTORI I MISHIT

Mishi i gjedhit tradicionalisht është konsideruar si nën-produkt i prodhimit të qumështit. Të gjithë viçat vijnë nga fermat prodhuese të qumështit, d.m.th nuk ekziston një zinxhir furnizimi i mishit, i kompletuar dhe specializuar. Stallat për majmëri janë kryesisht objekte të konvertuara nga objektet për prodhimin e qumështit ose objekte të ndërtuara nga vetë Fermeret e vegjël.

Për të shtuar profesionalizmin në mbarësitimin e gjedheve për mish, është e nevojshme që të përmirësohen njohuritë teknike të prodhuesve, sidomos të fillestareve, rreth praktikave të mbarësitimit të gjedheve për mish dhe prodhimit të ushqimit për kafshë duke i përshtatur trajnimet dhe shërbimin këshillimor. Mbarështuesit e gjedheve për mish gjithashtu kanë më shumë nevojë për investime në stalla dhe objekte ndërtimore. Investimet në makineri të fermës për prodhim të ushqimit për kafshë; investimet në menaxhimin e mbetjeve dhe plehut gjithashtu kanë prioritet të lartë. Ka nevojë për ndërtimin e stallave të reja dhe objekteve të fermave për mbarësitim të kafshëve për mish në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedis. Janë të nevojshme pajisje për fermë si: sistemi i furnizimit me ujë, sistemi i të ushqyerit, largimi i plehut të stallës pastaj makineria e fermës, sidomos për prodhimin, ruajtjen, përgatitjen, përdorimin dhe shpërndarjen e ushqimit të kafshëve. Me këtë masë do të synohet përkrahja për fermerët komercial të specializuar në majmëri të gjedheve.

Konsumi i mishit të shpezëve pritet të rritet edhe më tutje. Pasi që shumica e mishit të shpezëve importohet, ka një potencial të madh për zëvendësim të importit. Qasja e përmirësuar në shërbime dhe inpute e ka bërë këtë biznes të mundur edhe për operatorët e mesëm të cilët nuk kanë kapacitet që të ndërtojnë një cikël të mbyllur, nga prodhimi i ushqimit të kafshëve deri te tregtimi/shitja. Ka nevojë për investime në vendosje/strehim më të mirë të shpezëve, përgatitje të ushqimit cilësor, kontroll të cilësisë, monitorim të shëndetit si dhe ruajtje dhe trajtim të plehut të stallës. Kjo masë fokusohet në përkrahjen e prodhuesve ekzistues dhe atyre të rinj me madhësi mesatare të fermës, me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese në prodhimin vendor, duke rritur numrin e prodhuesve të mesëm të bojlerëve si dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të tyre. Përmes shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve profesionale duhet të përmirësohet cilësia e prodhimit me kosto sa më të ulët.

## SEKTORI I QUMËSHITIT

Qumështi i lopës është prodhimi më i rëndësishëm blegtoral në Kosovë. Viteve të fundit janë bërë përpjekje që prodhimi i qumështit të kalojë nga prodhimi për konsum familjar, në prodhim për treg, që të përmirësohen kushtet e mbarësitimit, të zbatohen praktikat e mira bujqësore në fermat prodhuese të qumështit dhe të rritet kapaciteti i bujqve për prodhim të qumështit me cilësi të lartë.



Megjithatë, cilësia e ulët e qumështit mbetet çështje me rëndësi për t'u trajtuar. Një anketë nga viti 2011 tregon që vetëm 20% e qumështit të freskët të përpunuar ishte në përputhje me standardet përkatëse të cilësisë. Ende ka mjaft hapësirë për përmirësim në asetet fizike si në objekte më të mira, pajisje më bashkëkohore të stallës, sisteme më të mira dhe më bashkëkohore të mjeljes. Masa synon prodhuesit komercial të qumështit.

Modernizimi i sistemeve bujqësore, sidomos të prodhimi intensiv blegtoral, mund të shpijë në një rritje të lirimit të gazrave serrë, të cilat kontribuojnë në ndryshimin klimatik. Masa do të përkrahë investimet në menaxhimin e plehut të stallës dhe objektet për ruajtjen e tij që zvogëlojnë lirimin e këtyre gazrave ndërsa prioritet do t'i jepet projekteve të modernizimit që përfshijnë investime të tilla.

Prodhimi i qumështit nga ripërtypësit e vegjël është kryesisht një cikël i mbyllur, nga prodhimi i qumështit, të përpunimi i djathit dhe shitja (marketingu) në fermë. Vetëm disa ferma janë komerciale ndërsa shumica e prodhuesve që mbajnë ripërtypës të vegjël janë ferma të vogla me praktika kryesisht tradicionale të mbarështimit të kafshëve. Ka nevojë të madhe për investime në modernizimin e stallave, për përdorimin sistemeve të mjeljes etj.

#### SEKTORI I DRITHËRAVE

Gruri dhe misri janë dy drithërat kryesor në Kosovë. Gruri kryesisht përdoret për konsum të njerëzve ndërsa misri kultivohet për prodhim të ushqimit foragjer. Sektorit i mungojnë inpute të cilësisë së lartë dhe një nivel i mjaftueshëm i makinerisë që mundëson prodhim konkurrues. Shkalla e ulët e mekanizimit është shkaktuar nga makineria e vjetruar (p.sh. kombajnati e grurit) ose mungesa e makinerive të caktuara (p.sh. kombajnati e misrit) dhe nga ngastrat e vogla të tokës të cilat vështirësojnë përdorimin efikas të makinerive. Ka nevojë të investohet në makineri të re me shfrytëzim eficient të energjisë.

#### SEKTORI I RRUSHIT

Ngastrat e vreshtave kryesisht janë të vogla ndërsa prodhimi i rrushit bëhet nga 9,000 vreshtarë. Madhësia mesatare është 0.5 ha me rendiment mesatar prej 8-10t/ha. Vreshtat e Kosovës përfshijnë 664 ha me rrush tryeze dhe 2,545 ha me rrush për verë. Shpenzimet e prodhimit janë të larta si rrjedhojë e kultivimit ekstensiv (pjesërisht për shkak të vreshtave të vjetra), ngastrat e vogla zvogëlojnë efikasitetin e kultivimit dhe mekanizimit të vjetër. Rrushi i tryezës i prodhuar në vend ballafaqohet me konkurrencë të fortë nga import i cili është i kategorizuar dhe paketuar në kuti kartoni. Prioritet do t'i jepet prodhimit të rrushit të tryezës me një potencial në rritje të konsumit në krahasim me konsumin e verës. Investimet në ristrukturimin dhe modernizimin e prodhimit dhe tregtimin e rrushit të tryezës janë të nevojshme për të konkurruar me importin.

#### SEKTORI I VEZËVE

Aktualisht janë 98 prodhues aktiv komercial të vezëve në Kosovë, secili me mbi 1,000 pula vojse të cilët së bashku prodhojnë rreth 40% të prodhimit të vezëve në Kosovë. Ende aplikohet sistemi i baterive me kafaze (*battery cage*) gjithkund dhe nuk ka prodhues të vezëve që aplikojnë mbajtjen në dysheme apo sistem të lirë (*free-range*). Objektet e prodhimit në shumicën e rasteve janë relativisht të vjetra dhe është vështirë të prodhohen inputet e kërkuara (ushqimet, zogjtë dhe zogëzat) me çmime konkurruese.



Për të optimizuar efikasitetin e prodhuesve mesatar, prioritetet do t'i jepet njësisve të mesme me nga 6,000 deri 50,000 pula vojse, të cilat mund të përballojnë lëvizjet e mëdha të çmimeve përgjatë viteve dhe konkurrojnë në tregun shumë dinamik.

Do të sigurohet përkrahje për të përmirësuar efikasitetin e prodhimit duke investuar në pajisje më të mira për stallë dhe higjienë në stallë (ajrosje, sistem të ujit, sistem të grumbullimit të vezëve dhe larjes etj). Duhet të përmirësohet menaxhimi i plehut të stallës dhe mbetjeve të tjera, pasi që ndikimi negativ i shpezëtarisë intensive në mjedis mund të jetë mjaft i lartë nëse nuk trajtohet si duhet, gjersa krijon të hyra shtesë kur menaxhohet si duhet. Sapo të themelohet plotësisht Sistemi Këshillimor në Kosovë do të ofrohet trajnimi i prodhuesve të mesëm dhe të vegjël në optimizimin e prodhimit të ushqimit të kafshëve, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave gjysmë-automatike për grumbullimin dhe kategorizimin e vezëve.

### 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit;
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- Përkrahja e bujqëve, në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial duke synuar rritje, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të kapitalit fizik;
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes promovimit të efikasitetit të resurseve dhe energjisë së ripërtitshme;

#### 3.1. Objektivat specifike

##### SEKTORI I PEMËVE DHE PERIMEVE (përfshirë patatet)

---

Objektivat specifike për sektorin e pemëve dhe perimeve (përfshirë patatet) janë:

- a. Rritja e prodhimit të pemëve dhe perimeve për qëllime komerciale;
- b. Përmirësimi me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- c. Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit
- d. Zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, infrastrukturë dhe pajisje për fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim.
- e. Përmirësimi i eficiencës së energjisë duke investuar në teknikat e ruajtjes së energjisë dhe në prodhimin e energjisë së ripërtitshme;
- f. Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e produkteve bujqësore

##### SEKTORI I MISHIT

---

Objektivat specifike për sektorin e prodhimit të mishit janë:

- a. Rritja e prodhimit të mishit në ferma të specializuara për majmëri;
- b. Përmirësimi me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- c. Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit;

- d. Zvogëlimi i lirimt të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik; dhe mosndotjes së ujërave mbitokësore dhe nëntokësore
- e. Përmirësimi i efijencës së energjisë duke investuar në teknikat e ruajtjes së energjisë dhe në prodhimin e energjisë së ripërtritshme;
- f. Përmirësimi i integritit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre.

#### SEKTORI I QUMËSHTIT

---

Objektivat specifike për sektorin e prodhimit të qumështit janë:

- a. Rritja e prodhimit të qumështit cilësor, në fermat e specializuara për qumësht;
  - b. Përmirësimi me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
  - c. Modernizimi i fermave dhe përmirësimi i higjienës së qumështit të freskët përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit;
  - d. Zvogëlimi i lirimt të oksidit të azotit dhe metanit përmes investimit në trajtim e duhur të plehut organik, si dhe mosndotja e ujërave mbitokësore dhe nëntokësore;
  - e. Përmirësimi i efijencës së energjisë duke investuar në teknikat e ruajtjes së energjisë dhe në prodhimin e energjisë së ripërtritshme;
  - f. Përmirësimi i integritit të fermerëve me blerësit/përpunuesit e produkteve të tyre.
- 

#### SEKTORI I DRITHËRAVE

---

Objektivat specifike për sektorin e prodhimit të drithërave:

- a. Ngritja e cilësisë dhe produktivitetit në prodhimin e drithërave;
- b. Përmirësimi me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- c. Modernizimi i fermave përmes përdorimit të mekanizimit modern
- d. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë duke investuar në teknikat e ruajtjes së energjisë;
- e. Përmirësimi i integritit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre.

#### SEKTORI I RRUSHIT

---

Objektivat specifike për sektorin e prodhimit të rrushit:

- a. Rritja e prodhimit të rrushit të tryezës dhe rrushit të verës;
- b. Përmirësimi me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- c. Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit
- d. Përmirësimi i efijencës së energjisë duke investuar në teknikat e ruajtjes së energjisë dhe në energjinë e ripërtritshme;
- e. Përmirësimi i integritit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre.

#### SEKTORI I VEZËVE

---



Objektivat specifike për sektorin e prodhimit të vezëve janë:

- a. Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese
- b. Përmirësimi gradual me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- c. Modernizimi i fermave përmes përdorimit të paisjeve të reja dhe mekanizimit përfshirë ato për prodhimin e ushqimit të kafshëve;
- d. Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit përkatës të plehut organik;
- e. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë duke investuar në teknikat e ruajtjes së energjisë dhe në prodhimin e energjisë së ripërtitshme;
- f. Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre.

#### 4. LIDHJA ME MASAT TJERA NË PBZHR

Kjo masë ka ndërlidhje me masat e tjera të PBZHR-së, si:

- "Investimet në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë"
- "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve"
- "Shërbimi Këshillimor".

#### 5. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTAR

Përfituesit përfundimtar nën këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (L-03/098) dhe ndërmarrjet tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermave.

Para kërkesës për pagesën përfundimtare, përfituesit janë të obliguar që të deklarojnë në regjistrin e fermave, kurse prodhuesit e rrushit edhe në regjistrin kadastral të vreshtave, çdo ndryshim në kapacitetin prodhues i cili rrjedhë nga investimi i bërë.

#### 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

6.1. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë për të gjitha masat e PBZHR-së, të paraqitura në kapitullin ne shtojcën 1 duhet të përmbushen nga të gjithë aplikantët.

6.2. Lloji i ekonomive bujqësore (fermave) të pranueshme

Përkrahja mund tu ipet ekonomive bujqësore (fermave) vetëm kur ato përmbushin kërkesat që janë parashtruar në seksionin 5 dhe me kusht të arritjes së pragjeve vijuese në fushën përkatëse të investimit:

*SEKTORI I PEMËVE (molla, dardha, kumbulla, vishnja, dredhëza, mjedra dhe manaferra)*

Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve), aplikantët duhet të dëshmojnë ekzistimin e sipërfaqeve në pronësi apo të marra me qira në Regjistrin e Fermave prej së paku 0.5 ha për pemë farore dhe/ose 0.25 ha për pemë manore (pemë të imta: dredhëza, mjedra dhe manaferra);

- Në rast të investimeve në makineri bujqësore dhe pajisje dhe/ose investime në ndërtim dhe përmirësim të objekteve, investimi duhet të përputhet me kapacitetet prodhuese;

#### SEKTORI I PERIMEVE, përfshirë patatet

- Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e perimtarisë/patateve, aplikantët duhet të dëshmojnë ekzistimin e sipërfaqeve të tokës së punueshme, në pronësi apo të marra me qira të regjistruar në Regjistrin e Fermave prej së paku 2 ha nëse aplikojnë për perime në fushë të hapur ose 4 ha nëse aplikojnë për patate;
- Në rast të investimeve në ndërtimin e serrave të reja permanente, ekonomia bujqësore (ferma) duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 ha tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave,

#### SEKTORI I MISHIT

- Për investime në sektorin e mishit (trashje e viçave dhe broilerëve), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë kafshë në momentin e aplikimit, por zotohen se do të kenë së paku 20 krerë viça ose 5,000 broilerë, dhe këto duhet ti dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë para paraqitjes së kërkesës për pagesën e fundit. Broilerët dhe viçat duhet të jenë të deklaruar në Regjistrin e Fermës kurse viçat edhe në Regjistrin për Identifikimin e Kafshëve.
- Ekonomitë bujqësore që aplikojnë për ndërtimin e stallës, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 6 muaj
- Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku 0.3 ha/kokë viçi të tokës bujqësore në pronësi apo të marrë me qira, në momentin e aplikimit. (nuk vlen për broiler)

#### SEKTORI I QUMËSHTIT

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e prodhimit të qumështit duhet të kenë së paku 15 lopë qumështore ose 150 dele ose 100 dhi në prodhimtari aktive, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin për Identifikim dhe Regjistrim të kafshëve në AUV.
- Ekonomitë bujqësore që aplikojnë për ndërtimin e stallës, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 6 muaj
- Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës aplikantët duhet të dëshmojnë posedimin e të paktën 0,5 ha të tokës bujqësore për çdo krerë lope.

#### SEKTORI I DRITHËRAVE

Aplikuesit për investime në sektorin e drithërave, duhet të dëshmojnë posedimin e tokës së punueshme në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe atë së paku 15 ha për drithëra ose 6 ha për misër;

#### SEKTORI I RRUSHIT

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë posedimin e tokës bujqësore në pronësi apo të marrë me qira, të regjistruar



në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin e Vreshtave, për së paku 10 vjet dhe atë 0.5 ha për rrush të tryezës ose 1 ha për rrush të verës.

- Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, aplikuesit duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku 4 hektar me vreshta, në pronësi apo të marrë me qira, dhe regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.

#### SEKTORI I VEZËVE

- Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 6,000 e më së shumti 50,000 pulave vojse në prodhimtari aktive, të regjistruar në Regjistrin e Fermës;
- Ndërmarrjet me më shumë se 50.000 pula vojse mund të aplikojnë vetëm për makineri dhe pajisje në kuadër të kësaj nën-mase.

#### 6.3. Standardet kombëtare

- Vendimi për të dhënë përkrahjen do të jetë i kushtëzuar me faktin që e tërë ekonomia (ferma) e përfituesit, duhet të jetë në përputhje me standardet përkatëse minimale kombëtare në fuqi, lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve, më së voni para pagesës përfundimtare të investimit. Përputhshmëria me kërkesat për mirëqenie të kafshëve të përcaktuara në Ligjin për Veterinarinë Nr. 2004/21, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/28 të datës 30 korrik 2004 dhe Ligjit për mirëqenien e kafshëve, Nr. 2005/02-L10, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/24 me 9 maj 2005 dhe Ligjit për Prodhimtarinë Blegtorale në Kosovë, Nr. 2004/33, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/39 të datës 14 tetor 2004;
- Përputhshmëria me kërkesat mjedisore kombëtare - Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Nr. 03/L-240;
- Projekti për vreshta do të jetë në përputhje me Ligjin për verëra Nr. 2005/02-08, të datës 14.10.2005 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/47 të datës 14 tetor 2005, dhe ndryshim-plotësimi i ligjit për verë 04/L-019

Një listë e plotë e freskuar e standardeve përkatëse minimale kombëtare do të bashkëngjitet udhëzuesit për aplikant dhe do të publikohet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë.

#### 6.4. Rentabiliteti ekonomik i ekonomive bujqësore (fermave)

- Aplikantët duhet të dëshmojnë, rentabilitetin ekonomik të ekonomisë bujqësore (fermave) pas realizimit të projektit. Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 Euro, rentabiliteti financiar pas investimit duhet të dëshmohet përmes projekt-propozimit teknik
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 Euro, rentabiliteti financiar pas investimit duhet të dëshmohet përmes planit të biznesit .
- Modeli për projekt-propozim teknik dhe për planin e biznesit do të publikohet në webfaqen e Agjencionit të Pagesave dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë përfituesit potencial si pjesë e formularit të aplikacionit.

## 6.5. Kriteret tjera të përbashkëta të pranueshmërisë

Aplikantët duhet të dëshmojnë njohuri të mjaftueshme bujqësore duke plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:

- të kenë shkollën e mesme dhe një deklaratë me shkrim me të cilën zotohen se do të ndjekin kurse trajnimi me së paku 150 orë mësimi, në fushën për të cilën aplikojnë, të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit
- shkollën e mesme bujqësore
- së paku tri vjet përvojë bujqësore (dëshmi nga punëdhënësi ose duke qenë të regjistruar për aq kohë në Regjistrin e Fermave)
- diplomë universitare në bujqësi, veterinarri apo teknologji ushqimi
- Në rastin e ndërmarrjeve bujqësore, kërkesat e sipërpërmendura aplikohen për menaxherin e ndërmarrjes.

Në rast të personave juridik, së paku një person i ndërmarrjes që e përfaqëson ekonominë bujqësore duhet të jetë i punësuar i përhershëm ose i punësuar me kontratë jo më të shkurtër sesa kohëzgjatja e përkrahjes financiare e këtij programi. Në rastin e projekteve të ndërtimit, aplikantët e përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës me Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të dorëzojnë:

1. Kopjen e skicave dhe një parallogaritje të shpenzimeve të punëve të parapara;
2. Pëlqimin e komunitetit

Kurse, para kërkesës për pagesë ne Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të dorëzojnë:

3. Lejen për ndërtim nga organi kompetent i komunës,
4. Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj dhe

Në rast të ndërtimit/renovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes, vreshtit dhe vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet dhe t'i bashkëngjitet pëlqimi i pronarit (qiradhënësit) për investimin që do të bëhet në tokën e tij.

*Vërejtje: Përfituesit e mekanizimit bujqësorë nga programi i zhvillimit rural të vitit 2013 nuk kanë te drejt të aplikojnë për mekanizëm bujqësorë ne programin e zhvillimit rural për vitin 2014*

## 7. KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË

Aplikantët për investime në sektorin e qumështit ose mishit duhet të kenë kafshë me matrikula të Republikës së Kosovës (nuk vlen për broiler).

Kafshët e importuara nga vendet e BE-së janë të pranueshme për aplikim me matrikujt e vendit të origjinës dhe dokumentet relevante nga AUV-së.

## 8. SHPENZIMET E PRANUESHME

8.1. Investimet e pranueshme janë:



Shpenzimet e pranueshme janë të limituara në ato që janë listuar në udhëzuesin për aplikant ( lista e shpenzimeve të Pranueshme). Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €.

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100,000€.

Gjithsej shpenzimet maksimale të pranueshme për tërë periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të jenë 500,000 € për përfitues.

Shpenzimet administrative nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme.

Investimet e papranueshme janë të paraqitura në udhëzuesin për aplikant (Lista e shpenzimeve të pa pranueshme)

## 8.2. Investimet e pranueshme indikative për sektor

### INVESTIMET NË SEKTORIN E PEMËVE

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me madhësi minimale prej 0.5 ha për pemë farore dhe 0,25 ha për pemë manore.
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë sipas praktikave efikase të ujitjes
- Investimet në pajisje efikase për energji ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme
- Investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas-vjeljes,
- Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas-vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave dhe objekteve për vendosjen e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe plehra artificiale.

### INVESTIMET NË SEKTORIN E PERIMEVE (PËRFSHIRË PATATET)

- Investimet në ndërtimin/riparimin dhe modernizimin e serrave të përhershme për perimtare apo fidanishte me madhësi minimale prej 0.1 ha. Investimet në pajisje efikase për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme,
- Blerja dhe instalimi i pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike dhe atyre për kultivim pa dhë (soil-less),
- Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në fermë sipas praktikave efikase të ujitjes,
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për mbrojtje të bimëve; plehërim, vjelje dhe pas-vjelje,
- Ndërtimin e objekteve për ruajtje të prodhimit, objekteve për mbajtjetë makinerisë bujqësore, dhe depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehërat artificiale.

### INVESTIMET NË SEKTORIN E MISHIT

- Ndërtimi/riparimi i stallave, objektet përcjellëse (deponi e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme)

- Investimet në pajisje për rritje të zogjve njëditor (pajisje për ngrohje, për ushqim furnizim me ujë etj.)
- Investimet në pajisje efikënte për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë,
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije
- Investimet për pastrimin e plehut organik, sistemet për manipulim dhe ruajtje.

#### INVESTIMET NË SEKTORIN E QUMËSHITIT

- Ndërtimi/renovimi i stallave, objektet përcjellëse (deponi e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit, mjeltore) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme)
- Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat,
- Investimet në pajisje efikënte për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë,
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije
- Investimet për pastrimin e plehut organik, sistemet për manipulim dhe ruajtje.

#### INVESTIMET NË SEKTORIN E DRITHËRAVE

- Investime në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të drithërave, makineri për mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije
- Ndërtimi dhe përmirësimi i pronës së paluajtshme si ndërtimi i siloseve, objekte për mbajtjen e makinerisë bujqësore, pajisjeve dhe depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehtrat artificiale.
- Investimet në pajisje efikënte për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme

#### INVESTIMET NË SEKTORIN E RRUSHIT

- Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, , zëvendësim) për rrush tryeze dhe rrush vere me madhësi minimale 0.5 ha për rrush të tryezës dhe 1 ha për rrush të verës,
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes sipas praktikave efikënte të ujitjes,
- Investimet në pajisje efikënte për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme,
- Investimet në vendosjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri,
- Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe rrethoja,
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas-vjeljes,
- Atyre që kanë mbi 4 ha vreshta u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim, etj. Objekte për mbajtje të makinerisë bujqësore dhe pajisjeve si dhe ndërtimi i depove për produktet për mbrojtje të bimëve dhe plehtrat artificiale.



## INVESTIMET NË SEKTORIN E VEZËVE

- Ndërtimi/renovimi i stallave
- Investime në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujëpiresët dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve etj.)
- Investime në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, manipulim, paketim dhe ruajtje të vezëve.
- Investimet në pajisje eficiente për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar të shpezëve me kapacitet i cili së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

### 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR NËN-SEKTOR

#### 9.1 Kriteret e përzgjedhjes për SEKTORIN E PEMËVE

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria		Pikët
1	Kapaciteti prodhues: sipërfaqe që do të ngritet, në rast të investimit për depo, ujitje, mbrojtje kundër breshërit dhe makineri pikat merren varësisht prej sipërfaqes ekzistuese apo/ dhe asaj që do të ngritet.	Pemë të imta	Pemë frutore	
		> 1 ha	> 5 ha	50
		≥ 0.75 ≤ 1.0 ha	≥ 4 ≤ 5 ha	45
		≥ 0.5 < 0.75 ha	≥ 3 < 4 ha	40
		≥ 0.35 < 0.5 ha	≥ 2 < 3 ha	35
	≥ 0.25 < 0.35 ha	≥ 1 < 2 ha	30	
2	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dorëzim për së paku 50% të prodhimit		10
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në pajisje efikase për energji dhe/ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme (min. 10% e investimit të pranueshëm)		10
4	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i kooperativës apo shoqatës së bujqve të nivelit nacional		5
5	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vendeve të reja të punës.		5
6	Pozita e investimit	Investimi në viset malore		5
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit		5
8	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë përkatëse		5
9	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare		3
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër		2
GJITHSEJ (maksimum)				100

Në rast kur aplikantët kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet me shpenzime të pranueshme me vlerë më të lartë për kriterin e parë. Nëse edhe më tutje numri i pikëve mbetet i njëjtë, merret për bazë kriteri në vazhdim sipas të njëjtit parim.

#### 9.2 Kriteret e përzgjedhjes për SEKTORIN E PERIMËVE (përfshirë patatet)

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Lloji i investimit: 1. Për serra, 2 dhe 3 për perime në fushë të hapur dhe/ose patate (maksimum 50 pikë)	1. Rritja e sipërfaqeve të serrave	50
		2. Makineri bujqësore dhe pajisje	45
		3. Ndërtim i depos ftohëse	40
2	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dorëzim për së paku 50% të prodhimit	10
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në pajisje efikase për energji dhe/ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme (min. 10% e investimit të pranueshëm)	10
4	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i kooperativës apo shoqatës së bujqve te nivelit nacional	5
5	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vende të reja të punës.	5
6	Pozita e investimit	Investimi në viset malore	5
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	5
8	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë përkatëse	5
9	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare	3
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

#### 9.3 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e mishit

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria		Pikët
1	Lloji i investimit (maksimum 30 pikë)	Ndërtimi/renovimi i shtallës		30
		Përmirësimi i infrastrukturës		25
		Ndërtimi i depove		20
		Makineri dhe pajisje bujqësore		15
2	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit	Gjedhë	Broiler	20
		≥ 20<50 krerë	≥ 5,000<10,000 krerë	



		≥ 50 krerë	≥ 10,000 krerë	15
3	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dorëzim për së paku 50% të prodhimit		10
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në pajisje efikase për energji dhe/ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme (min. 10% e investimit të pranueshëm)		10
5	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i kooperativës apo shoqatës së bujqve te nivelit nacional		5
6	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vendeve të reja të punës.		5
7	Pozita e investimit	Investimi në viset malore		5
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit		5
9	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë përkatëse		5
10	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare		5
11	Raca e kafshëve	Aplikuesi dëshmon pastërtinë e racës së përshtatshme për së paku 50% të kafshëve		3
12	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër		2
GJITHSEJ (maksimum)				100

#### 9.4 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e qumështit

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria		Pikët
1	Lloji i investimit (maksimum 35)	Ndërtimi/renovimi i stallave		35
		Përmirësimi i infrastrukturës së fermës		30
		Ndërtimi i depove të ushqimit dhe plehut		20
		Makineri dhe pajisje bujqësore		15
2	Kapaciteti prodhues: nr. i kafshëve në prodhimtari aktive para aplikimit	Lopë qumështore	Dele/dhi qumështore	
		≥ 15 <25 krerë	≥ 150/100 < 300 krerë	15
		≥25 krerë	≥ 300 krerë	5
3	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dërgim te së paku 50% të prodhimit të fermës		10
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në pajisje efikase për energji dhe/ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme (min. 10% e investimit të pranueshëm)		10

5	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i shoqatës së prodhuesve të qumështit të nivelit nacional	5
6	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vende të reja të punës.	5
7	Vendndodhja e investimit	Investimi në viset malore	5
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	5
9	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë përkatëse	5
10	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare	3
11	Raca e kafshëve	Aplikuesi dëshmon pastërtinë e racës së përshtatshme për së paku 50% të kafshëve	3
12	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

#### 9.5 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e drithërave

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët	
1	Lloji i investimit	Makineri dhe pajisje bujqësore	35	
		Ndërtimi i siloseve	30	
2	Kapaciteti prodhues: sipërfaqja e tokës në pronësi	drithëra	misër	
		> 25 ha	>10 ha	25
		≥ 15 < 25 ha	≥6<10	20
3	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dërgim të së paku 50% të prodhimit të fermës	10	
4	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i kooperativës apo shoqatës së bujqve te nivelit nacional	5	
5	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vende të reja të punës.	5	
6	Vendndodhja e investimit	Investimi zbatohet në zonat malore	5	
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të	5	



		MBPZHR në tri vitet e fundit	
8	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë përkatëse	5
9	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare	3
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

#### 9.6 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e rrushit

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Kapaciteti prodhues: sipërfaqe që do të ngritet, në rast të investimit për depo dhe makineri pikat merren varësisht prej sipërfaqes ekzistuese apo/dhe asaj që do të ngritet.	> 4 ha rrush	40
		$\geq 3 \leq 4$ ha rrush	35
		$\geq 2 < 3$ ha rrush	30
		$\geq 1 < 2$ ha rrush	25
		$\geq 0.5 < 1$ ha rrush	20
2	Struktura e varieteteve në vresht	Maksimum 1 varietet/ për ha	10
		Më shumë se 1 varietet për ha	5
3	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	10
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në pajisje efikase për energji dhe/ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtitshme (min. 10% investimit të pranueshëm)	10
5	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i kooperativës apo shoqatës së bujqve te nivelit nacional	5
6	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vende të reja të punës.	5
7	Vendndodhja e investimit	Komuna: Rahovec, Suharekë, Prizren, Gjakovë	5
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	5
9	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë	5

		përkatëse	
10	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare	3
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ maksimum			100

### 9.7 Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e vezëve

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Lloji i investimit (maksimum 25 pikë)	a) Ndërtimi i stallave	25
		b) Përmirësimi i infrastrukturës së fermës	20
		c) Ndërtimi i depove të ushqimit/trajtimit	15
		d) Makineri dhe pajisje bujqësore	10
2	Kapaciteti prodhues: nr. i pulave vojse	$\geq 6,000 < 20,000$ pula vojse	15
		$\geq 20,000 \leq 50,000$ pula vojse	10
		$> 50,000$ pula, vetëm për investime nën b), c) dhe d) të kriterit të parë	
3	Mënyra e mbajtjes së pulave	Pa kafaz, në natyrë	10
		Pa kafaz, në dysHEME	8
		Kafaz sipas standardeve të BE-së	5
4	Orientimi komercial i prodhimit bujqësor	Marrëdhënie kontraktuale për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	10
5	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimet në pajisje efikase për energji dhe/ose prodhim i energjisë në fermë nga burimet e ripërtritshme (min. 10% e investimit të pranueshëm)	10
6	Aktivitetet e përbashkëta të bujqve	Aplikuesi është anëtar i kooperativës apo shoqatës së bujqve të nivelit nacional	5
7	Punësimi	Aplikuesi zotohet se do të krijoj vende të reja të punës.	5
8	Vendndodhja e investimit	Investimi zbatohet në zonat malore	5
9	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR në tri vitet e fundit	5
10	Arsimimi	Shkolla e mesme bujqësore apo diplomë përkatëse universitare në bujqësi dhe mbi 3 vite përvojë përkatëse	5



11	Përputhja me standardet minimale kombëtare	E tërë prona (ferma) përmbushë standardet minimale kombëtare	3
12	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ (maksimum)			100

## 10 SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

Intensiteti total i përkrahjes publike (nga buxheti kombëtar dhe fondet e BE-së) mund të jete deri në 60% të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Përkrahje shtesë jepet për:

- 5% për investimet në ekonomi bujqësore (ferma) nga fermerët e ri
- 10% për investimet në ekonomitë bujqësore (ferma) në viset malore (lista në udhëzuesin për aplikant)
- 10% për investimet në gropë septike për mbrojtje të mjedisit.

## 11 BUXHETI INDIKATIV

Ndarja e planifikuar buxhetore ndërmjet sektorëve për vitin 2014 është si vijon:

Sektorët	Vlera në euro	% e buxhetit indikativ
101.1	Spektori i pemëve	1,200,000 21%
101.2	Spektori i perimeve (përfshirë patatet)	1,400,000 24%
	Nga te cilat:	
	Serra	1,000,000
	Perime në fushe të hapur	400,000
101.3	Spektori i mishit, nga te cilat;	1,000,000 17%
	Trashje e viçave	500,000
	Brojleret	500,000
101.4	Spektori i qumështit, nga te cilat	1,150,000 20%
	Lope qumështore	800,000
	Dele dhe dhi	350,000
101.5	Spektori i drithërave	500,000 9%
101.6	Spektori i rrushit	200,000 3%
101.7	Spektori i vezëve	300,000 5%
Gjithsej		5,750,000 100%

## 12 TREGUESIT DHE PIKËSYNIMET

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku për 2014		
Inputi	Total	5,750,000		
	101.1 Sektori i pemëve	1,200,000		
	101.2 Sektori i perimeve përfshirë patatet	1,400,000		
	101.3 Sektori i mishit	1,000,000		
	101.4 Sektori i qumështit	1,150,000		
	101.5 Sektori i drithërave	500,000		
	101.6 Sektori i rrushit	200,000		
	101.7 Sektori i vezëve	300,000		
Output	Numri i përgjithshëm i fermave të përkrahura	98		
	Prej të cilave	101.1 Sektori i pemëve	15	
		101.2 Sektori i perimeve	27	
		101.3 Sektori i mishit	20	
		101.4 Sektori i qumështit	19	
		101.5 Sektori i drithërave	7	
		101.6 Sektori i rrushit	4	
		101.7 Sektori i vezëve	6	
	Vlera e investimeve (€)		9,133,654	
	Prej të cilave	101.1 Sektori i pemëve	1,906,154	
		101.2 Sektori i perimeve përfshirë patatet	2,223,846	
		101.3 Sektori i mishit	1,588,462	
		101.4 Sektori i qumështit	1,826,731	
		101.5 Sektori i drithërave	794,231	
		101.6 Sektori i rrushit	317,692	
101.7 Sektori i vezëve		476,538		
Rezultati	Numri i përgjithshëm i fermave me kapacitet të zgjeruar	73		
	Numri i përgjithshëm i fermave të modernizuara që kanë aplikuar produkte dhe/ose teknologji të re	32		
	Rritja e madhësisë së fermave të përkrahura	Nr. i hektarëve të shtuar me pemë farore	55	
		Nr. i hektarëve të shtuar me pemë të imta	10	
		Nr. i m <sup>2</sup> me serra të reja	85,020	
		Nr. i hektarëve të shtuar me rrush	16	
		Nr. i kafshëve të shtuara	Lopë qumështore	120
			Pula vojse	22,500
			Broiler	12,500
			Gjedhe për trashje	63
	Numri i fermave që përmbushin standardet relevante nacionale dhe ato të BE-së	4		
	Depot të reja pemëve dhe perimeve (tona/vit)	1,719		
	Numri i fermave që kanë investuar në aktivitetet pasvëljes (paketim, klasifikim, etiketim etj.)	3		
	Numri i fermave që kanë ndërtuar depot e plehut.	36		
	Numri i fermave që kanë investuar në ruajtjen e energjisë	67		
Numri i fermave që prodhojnë energji të ripërtëritshme	11			
**Ndikimi	Të hyra shtesë (euro/vit)	2,326,717		



	Vende të reja të punës me orar të plotë	136
	Rritja e produktivitetit të punës, si rritje (në %) e të hyrave shtesë, bruto për çdo vend pune, në fermat e perkrahura	

\*Caqet janë vendosur në bazë të buxhetit të parashikuar, prandaj çdo ndryshim i buxhetit do të reflektohet proporcionalisht në indikatorë.

\*\*Vlerësimi të bëhet nga vlerësues të pavarur

### **13 PROCEDURA ADMINISTRATIVE**

Kjo masë do të implementohet nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencioni i Pagesave. Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në udhëzimin administrativ i cili miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe do të publikohet në gazetën zyrtare.

### **14 FUSHËVEPRIMI GJEOGRAFIK I MASËS**

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

## M103 INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE ATYRE TË PESHKATARISË

### 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 01 korrik 2009
- Ligji Nr. 03/L-016, Për Ushqim. dt. 06 mars 2009
- Ligji Nr. 03/L-029 Për inspektionin e bujqësorë, dt. 13 dhjetor 2008;
- Ligji Nr. 02/L-26 Për tokën bujqësore, dt. 23 qershor 2006;
- Ligji Nr. 2005/47 Për verërat ,dt. 14 tetor 2005;
- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorin, dt. 28 qershor 2013;
- Ligji Nr 2005/02-L10, Nr. 2005/24 Për Mirëqenien e Kafshëve, dt. 9 maj 2005
- Ligji Nr. 03/L-024 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dt. 19 mars 2009;
- Ligji Nr. 03-L-025 për mbrojtjen e mjedisit, dt. 19. mars. 2009
- Ligji Nr. 04/L-074 Për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim Rural, dt. 19 Mars 2012.

### 2. ARSYESHMËRIA

#### NË PËRGJITHËSI (PËR TË GJITHË SEKTORËT E PËRMENDUR MË POSHTË)

Përkrahja për këtë masë është e përqendruar në investimet në asetet fizike me qëllim që të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit agro-ushqimor për zëvendësimin e importit të ushqimit me prodhime vendore me cilësi të lartë dhe një produktivitet të përmirësuar.

Kjo masë synon të përkrahë investimet në industrinë e përpunimit të ushqimit në pesë nën-sektorë: përpunim të qumështit, përpunim të mishit, përpunim të frutave dhe perimeve dhe prodhimit të verës. Masa është projektuar për të plotësuar masën 101, me synim të rritjes së furnizimit me produkte bujqësore të sigurta, pa ndikime negative në mjedis.

Për të konkurruar me sukses në një treg gjithnjë e më të hapur për përpunim të ushqimit, industria ka nevojë për modernizimin e teknologjive dhe të përmirësoj sistemet e menaxhimit të sigurisë. Industria ushqimore ka për detyrë të krijoj grumbullim të sigurt, transportim dhe deponimin e lëndëve të para për zvogëlimin e mbeturinave dhe për të garantuar sigurinë e ushqimit.

Nën këtë masë, përparësi u ipet investimeve për themelimin e sistemeve të standardeve të sigurisë së ushqimit që kanë rëndësi të veçantë për furnizimin e tregut vendor me prodhime të sigurta ushqimore dhe për konkurrim të suksesshëm me furnizuesit e huaj. Për të inkurajuar adaptimin e industrisë me standardet mjedisore, prioritet u është dhënë investimeve që synojnë trajtimin e mbeturinave, pastrimin e ujit dhe shfrytëzimin e produkteve të mbeturinave. Investimet e mbështetura në masën 103 do të kontribuojnë në përmirësimin e situatës së prodhimit bujqësor primar, duke u dhënë përparësi përfituesve që sigurojnë një përqindje të lartë të lëndëve të para me anë të kontratave me fermerët. Prioritet në këtë masë i është dhënë investimeve të bëra në zonat malore në sektorin e përpunimit të qumështit.

#### PËRPUNIMI I QUMËSHITIT

Industria e përpunimit të qumështit është një nga sektorët kryesorë të industrisë ushqimore në Kosovë, dhe një ndër më të mëdhenjët. Industria e përpunimit të qumështit ka qenë një prioritet sipas skemave kombëtare dhe granteve të BE-së të mbështetura në 3 vitet e fundit.



Megjithatë, mbështetja e marrë është larg nevojave për mbulim të investimeve të ndërmarrjeve të përpunimit të qumështit në aspektin e shtrirjes me standardet e BE-së në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e investimeve të ripërtërirjes së energjisë. Përveç kësaj sektori i qumështit ka nevojë për investime të konsiderueshme për modernizimin e teknologjive të aplikuara, për të rritur produktivitetin dhe për të ndjekur kërkesat në ndryshim të konsumit. Zinxhirët e mbyllur të ftohjes nga prodhuesi e deri te konsumatori, qendrat grumbulluese të qumështit dhe kamionët e transportit të qumështit me sisteme të ftohjes duhet mbështetur.

Industria e përpunimit të qumështit ka përqëndruar përpjekjet e saj në një gamë të kufizuar të produkteve, kryesisht qumështin dhe produktet e freskëta të qumështit, duke i kushtuar më pak vëmendje djathit, i cili kërkon më shumë njohuri dhe ka një qarkullim të ngadaltë. Disa ndërmarrje të vogla të qumështit kanë futur produkte të reja, të tilla si djath dhe djathin nga qumështi i deleve dhe ai i lopës.

Masa synon rreth 36 subjekte të regjistruara për përpunimin e qumështit me kapacitete të ndryshme të përpunimit nga 200/l deri në 100.000/l.

Në këtë grup bëjnë pjesë edhe 3 ndërmarrje, që përfshijnë më shumë se 50% të kapacitetit të prodhimit të përgjithshëm të sektorit të cilat kanë një linjë të plotë, përpunimin e qumështit dhe produkteve të qumështit me një nivel të kualitetit të përafërt me standardet e Komunitetit Evropian (të klasifikuar në kategorinë "A" në aspektin e përputhshmërisë me standardet). Këto ndërmarrje kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme teknologjike për të përmirësuar dhe zgjeruar rrjetin e tyre të furnizimit me lëndë të para të qumështit, që në mënyrë efikase të përdorin kapacitetin e prodhimit, për të forcuar konkurrencën dhe për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të mbeturinave. Kapaciteti i instaluar i impianteve të mëdha të përpunimit përdoret vetëm pjesërisht, ndërsa njësitë më të vogla të qumështit përdorin tashmë një pjesë të mirë të kapacitetit të instaluar të tyre. Disa prej ndërmarrjeve kanë përdorur mbi 50% të kapacitetit të tyre. Masa synon gjithashtu rreth 33 ndërmarrje të mesme dhe të vogla të përpunimit. Përmes granteve të BE-së dhe projekteve të mbështetura nga donatorët, disa prej tyre u ndihmuan për të zhvilluar aftësitë dhe strategjitë e marketingut, për të futur produkte të reja dhe për të përmirësuar sigurinë ushqimore dhe standarde të cilësisë. Ata kanë nevojë për ndihmë për të diversifikuar linjën e prodhimit, për të rritur produktivitetin, për të zgjeruar dhe për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e sigurisë për ushqim. Praktikën e përpunueseve të qumështit të dhisë dhe deles nga rajonet malore janë në fokus në mënyrë që të inkurajojnë prodhimin e produkteve tradicionale lokale apo risive në mënyrë që të ndikojë në rritjen dhe ruajtjen e vendeve të punës.

*Shënim: Kategoritë e rrezikuara janë të definuara nën "Kriteret specifike të pranueshmërisë"*

## PËRPUNIMI I MISHIT

### *Thertoret*

Në Kosovë ekzistojnë 49 thertore- 6 thertore të pulave dhe 43 të tjera, që janë të regjistruara në AUV dhe janë operacionale. Nga këto institucione, dy janë regjistruar me "A" (d.m.th klasa e ulët e rrezikut) dhe 22 me "B", 15 me "C" dhe 10 me "D" (d.m.th. Klasës së lartë të rrezikut).

Kapaciteti i instaluar si një tërësi është konsideruar përtej nevojave, duke marrë parasysh prodhimin total të mishit, duke përfshirë edhe vlerësimin jo formal të therrjes. Në anën tjetër vetëm 2 ndërmarrje janë të regjistruara për therrjen e ripërtypësve të vegjël që është e



pamjaftueshme për të mbuluar nevojat, veçanërisht në zonat e largëta dhe ato malore . Shumica e thertoreve ekzistuese janë pjesë e bizneseve më komplekse (p.sh. përpunimit të mishit , prodhimin e brojlerëve etj). Thertoret janë ndotës të mëdhenj të sektorit të industrisë ushqimore si në gjendje të lëngshme po ashtu edhe në formë të mbeturinave të ngurta nga therja, kështu që nevoja për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve dhe ujit do të mbështetet. Shumë prej ndërmarrjeve kanë marrë mbështetje për investime nga BE dhe skemat e granteve të donatorëve, por ka nevojë të madhe për mbështetjen e investimeve të mëtejshme për përmirësimin e standardeve të sigurisë së ushqimit dhe të kontrollit të cilësisë. Një tjetër çështje e rëndësishme do të jetë shtimi i i linjave të specializuara, pasi që tani janë vetëm dy thertore të regjistruara që kanë linja të specializuara për ripërtypësit e vegjël. Diversifikimi i prodhimeve ( mishin e copëtuar në pjesë, produktet e gatshme për restorante / nevojat e hoteleve etj), mund të rrisin vlerën e prodhimeve në këtë sektor.

Mbështetja për këtë masë do të ndahet për thertoret ekzistuese e jo për të rritur numrin e tyre. Në raste sipas rregullit të justifikuar thertoret e reja do të mbështeten vetëm nëse bëjnë zëvendësimin e objekteve të vjetra me të reja, ose në rast të ndërtimit të thertoreve të reja për pula dhe ripërtypës të vegjël në komunën ku objektet e tilla mungojnë ose nuk kanë qasje në çmimet e tregut.

#### *Ndërmarrjet për përpunim të mishit*

Industria e përpunimit të mishit në Kosovë është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, por ende karakterizohet nga një numër i kufizuar i produkteve të ofruara nga një numër i vogël i ndërmarrjeve, dhe vetëm katër prej tyre e kanë të deklaruar kapacitetin e përpunimit. Aktualisht, industria është e ndarë në dy nivele:një i bërë nga pesë ndërmarrje të deklaruara me kapacitet prej 20 ton/ ditë ose më shumë, të gjitha me një gradë rreziku "A"ose "B" dhe 36 të deklaruar me kapacitet prej 5 ton/ ditë ose më pak,me nivele të ndryshme të përputhshmërisë me kërkesa të sigurisë dhe cilësisë. Masa do të mbështesë ndërmarrjet ekzistuese të përpunimit për të rritur përputhshmërinë e tyre me sigurinë e ushqimit, mjedisin (asgjësimin e mbeturinave dhe menaxhimin e ujit) dhe kërkesat e kontrollit të cilësisë, për të zgjeruar vargun e tyre të produkteve,futjen e teknologjive të reja të prodhimit dhe të produkteve të reja,si dhe duke investuar në projekte për ripërtrirjen e energjisë.

#### *SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PEMEVE DHE PERIMEVE, DUKE PËRFSHIRË EDHE PRODHIMTARINË E VERËS*

---

SEKTORI I PEMEVE është i fokusuar në mollë, kumbulla, luleshtrydhe të fushës, mjedra dhe manaferra (pemë të buta). Grupet e fermerëve nuk janë në gjendje të organizojnë qendra të grumbullimit të frutave të nevojshme për të ofruar sasi të vlerësueshme dhe mirë të paketuara të frutave. Pra, ka nevojë për përmirësimin e kësaj gjendje për të përmbushur kërkesat e tregtarëve me shumicë.

Kosova ka një traditë të gjatë në përpunimin e perimeve, si një pjesë integrale e zinxhirit të ushqimit të çdo familje me metoda të lashta të përgatitjes: është vlerësuar se një sasi e konsiderueshme e perimeve të përpunuara janë duke u prodhuar në shtëpi dhe për konsum vetanak. Kapaciteti i përpunimit në Kosovë, së paku në aspektin e dimensioneve, në masë të madhe e kalon kapacitetin e prodhimit. Edhe pse sektori është i fragmentuar në përgjithësi, disa



nga pjesëmarrësit kyç janë të përqendruar në një pjesë të konsiderueshme të tregut.- Tri veraritë më të mëdha dhe dhjetë kompanitë e përpunimit për pemë dhe perime janë dominuese në sektor. Në vitet e fundit përpunuesit e vegjël kanë filluar për të prodhuar produkte të tilla si fruta, reçel frutash, sallata etj. Në ditët e sotme linjat e produkteve të frutave dhe perimeve përbëjnë turshi, lëng, perime të konservuara, reçel, marmelatë, ajvar etj. Kapaciteti i tharjes është i kufizuar, duke u përdorur kryesisht për bimët mjekësore dhe ato aromatike.

Masa synon që të gjitha ndërmarrjet e përpunimit të frutave dhe perimeve të fokusohen në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit dhe reduktimin e humbjeve në procesin e prodhimit.

Sistemet e sigurisë ushqimore janë aplikuar në një numër shumë të kufizuar të ndërmarrjeve. Futja e sistemeve të sigurisë ushqimore kërkon investime në përmirësimin e teknologjisë dhe përmirësimin e kushteve në objektet e tyre të prodhimit dhe përvetësimin e pajisjeve të kontrollit të kualitetit dhe sistemet e IT-së. Rritja e kapacitetit të magazinimit është e nevojshme për përmirësimin e tregut të prodhimeve të hortikulturës dhe patates dhe do të kanë nevojë për linjat e klasifikimit, kategorizimit dhe paketimit për të rritur cilësinë e produktit përfundimtar dhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë vendore të sektorit. Objektet e duhura pas-vjeljes dhe zinxhiri për ftohje janë të një rëndësie kyçe për cilësinë në zinxhirin e vlerës së perimeve. Disponueshmëria për objekte të magazinimit me sisteme të ftohjes është në rritje, por ende tejet të kufizuara dhe të përqendruara në disa fusha dhe niveli i arritjes së standardeve të cilësisë ka nevojë për përmirësim. Prandaj, masa mbështet përmirësimin dhe trajtimin pas vjeljes dhe ruajtjes për lëndë të parë dhe depove për paketim.

Në përgjithësi 17 verari janë të licencuara aktualisht për procesin e përpunimit të rrushit dhe produkteve të tjera nga rrushi dhe vera, ndërsa më shumë se 20 verari të tjera ekzistojnë, por nuk janë të regjistruara. Tri janë ato më të mëdha, që përfaqësojnë përafërsisht 90% të kapacitetit të prodhimit të sektorit, ndërsa qendrat e tjera janë të prodhuesve të vegjël, disa prej tyre me potencial të mirë për eksport. Nën-sektori i verës ka nevojë të përmirësojë praktikën teknologjike dhe ende karakterizohet nga një mentalitet i prodhimit të verës në sasi të madhe, i cili nuk lejon rritje të madhe në treg, edhe pse pjesa më e madhe e tij është zvogëluar por në çdo rast nuk ka siguruar vlera të kënaqshme të shtuara .

Si rezultat i privatizimeve të mëparshme të verarive më të mëdha, kapaciteti aktual i përgjithshëm brenda këtyre verarive tejkalon prodhimin ekzistues vendor.

Në sektorin e verës kjo masë u dedikohet 17 verarive të regjistruara në Regjistrin e Prodhuarëve të Verës në Kosovë dhe projekteve fillestare të qëndrueshme/zbatueshme me kusht që të kenë të paktën 4 ha vreshta dhe të regjistrohen para kërkesës për pagesën e fundit.

### 3 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË MASËS

- Të rrisë aftësinë e sektorit agro-ushqimor për të përballuar presionin konkurrues përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive të reja dhe produkteve të reja.
- Përmirësimi i standardeve të BE dhe përmirësimet e synuara në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve, mirëqenien e kafshëve dhe gjurmueshmërinë e zinxhirit të ushqimit dhe menaxhimin e mbeturinave.

- Forcimi i lidhjeve me prodhimin primar.
- Për të ndihmuar në trajtimin e sfidës së ndryshimit të klimës, duke promovuar ripërtëritjen e energjisë.

#### 4.1 Objektivat specifike dhe investimet e pranueshme për sektor të mbështetur

##### *PËRPUNIMI I QUMËSHTIT*

---

Objektivat specifike për sektorin e përpunimit të qumështit janë:

- Përmirësimi gradual në përputhshmeri me me standardet kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e qumështit (higjiena, siguria ushqimore)
- Modernizimi i linjave të përpunimit të qumështit dhe objekteve tjera përcjellëse ( depot ruajtëse/ ftohëse) duke futur pajisje të reja;
- Futja e prodhimeve të reja / diversifikimi i prodhimeve në industrinë e qumështit
- Përmirësimi i marketingut për prodhimin e qumështit dhe prodhimeve të qumështit;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe
- Rritja e efijensës së energjisë duke investuar në prodhimin e energjisë së ripërtitshme

Investimet e pranueshme për sektorin

- Investimet në riparimin dhe modernizimin e qumështoreve;
- Investimet në pajisjet për përmirësimin e higjienës dhe cilësisë së prodhimeve, laboratorëve dhe pajisjeve për të përmirësuar dhe kontrolluar cilësinë e prodhimeve (ISO, HACCP);
- Investimet në pajisjet për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit; menaxhimi i mbetjeve dhe ujit;
- Investimet në pikat grumbulluese të qumështit dhe në transportin e specializuar;
- Investimet në pajisje për prodhimet e reja dhe paketimet bashkëkohore;

Investimet në teknologjinë për prodhimin e energjisë së ripërtitshme .

##### *PËRPUNIMI I MISHIT*

---

Objektivat specifike të sektorit janë:

- Përmirësimi gradual në përputhshmëri me standardet kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e mishit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenien e mjedisit dhe të kafshëve);
- Futja e linjave të reja të përpunimit të mishit/ diversifikimi;
- Modernizimi i thertoreve duke përfshirë thertjet e specializuara (për dele dhe dhi);
- Përmirësimi i marketingut të mishit dhe produkteve të mishit;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave ;
- Rritja e efijencës së energjisë duke investuar në prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Investimet e pranueshme për sektorin



### *Thertoret*

- Rinovimi, zgjerimi dhe zëvendësimi i thertoreve ekzistuese – përfshirë depotë ftohëse;
- Ndërtimi i thertoreve të reja;
- Pajisjet dhe objektet për mënjanim, grumbullim dhe trajtim të parë të lëkurave;
- Pajisjet për thertore;
- Ndërtimi / rindërtimi i depove ftohëse;
- Kamionët special për bartjen e kafshëve të gjalla që plotësojnë kërkesat për mirëqenien e kafshëve;
- Shtalla për vendosjen e kafshëve para therjes.
- Kamionët frigoriferë për bartjen e mishit;
- Makinat, pajisjet dhe depot për trajtim të mbetjeve dhe nën produkteve
- Investimet në vendosjen e sistemeve të sigurisë së ushqimit (GHP, GMP, HACCP);
- IT, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Investimet për ripërtirjen e energjisë;

### *Njësitë tjera për përpunimin e mishit*

- Rinovimi, zgjerimi dhe zëvendësimi i objekteve ekzistuese – përfshirë depot ftohëse bashkë me investimet ose pajisjet;
- Investimet në pajisje të reja dhe zgjerimi / zëvendësimi i pajisjeve ekzistuese, të cilat do të rrisin efikasitetin e prodhimit ( duke përfshirë efektivitetin e energjisë) dhe për futjen e prodhimeve të reja;
- Investimet për përafrim me standardet e sigurisë dhe cilësisë;
- Investimet për diversifikim të prodhimeve dhe/ose rritjen e efikasitetit në ciklin e prodhimit;
- Investimet në mbrojtjen mjedisore, pajisjeve për trajtim dhe eliminim të mbetjeve
- Objektet dhe pajisjet për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët e brendshëm;
- Futja e sistemeve për menaxhimin e cilësisë (ISO, HACCP);
- Dhoma për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- Automjetet speciale për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme të shitësit me pakicë;
- Investimet në projektet për ripërtirjen e energjisë dhe ruajtjen e saj.

## SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PEMEVE DHE PERIMEVE, DUKE PËRFSHIRË EDHE PRODHIMIN E VERËS

### Objektivat specifike për sektorin

- Përmirësimi gradual i përputhshmerise me standardet kombëtare dhe atyre të BE-së në përpunimin e pemëve, perimeve dhe verërave (siguria ushqimore, cilësia)
- Përmirësimi i teknologjisë së përpunimit të pemëve, perimeve dhe verës si dhe objekteve tjera përcjellëse ( depot ruajtëse/ ftohëse) duke futur pajisje/ teknologji të reja;
- Diversifikimi i prodhimeve/ përpunimit në industrinë e pemëve, perimeve dhe verërave
- Përmirësimin e marketingut për prodhimin e frutave dhe perimeve, duke përfshirë edhe verën;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe
- Rritja e eficiencës së energjisë duke investuar në prodhimin e energjisë së ripërtitshme

## Investimet e pranueshme

### *Përpunimi i frutave dhe perimeve*

- Ndërtimi / Rindërtimi / modernizimi i objekteve për përpunim që përdoren për aktivitetin e përpunimit, në përputhje me standardet relevante të komunitetit;
- Linjat për konservimin / pasterizimin e frutave dhe perimeve ,pajisje për tharje/tunele,etj;
- Objektet dhe pajisjet për trajtim pas vjeljes, trajtimin dhe deponimin e lëndës së parë, depo për material paketues;
- Pajisje për paketim, etiketim , përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit , dhe pajisje të tjera të specializuara ;
- Investimet në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme ,
- Pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohtje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, transporti me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë në zinxhirin e ftohtë ;
- Objektet dhe pajisjet për kontrollin e cilësisë , duke përfshirë edhe laboratorët në fabrikë ;
- Futja e sistemeve për menaxhimin e cilësisë ( ISO) dhe sistemit të sigurisë së ushqimit (HACCAP);  
Investimet në mbrojtje mjedisore, pajisjet për trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave ;
- Automjetet e specializuara të transportit , duke përfshirë transportin për lëndë të parë dhe të produkteve të gatshme , me kondicionerë dhe pa kondicionerë ;  
Sistemet e IT-së përfshirë software për menaxhimin e prodhimit dhe procesit.

### *Prodhimi i verës*

- Ndërtimi / rindërtimi i objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;
- Pajisje për përpunimin e verës;
- Futja e sistemeve të menaxhimit të cilësisë (ISO), etj;
- Investimet për ngritjen e sistemeve të sigurisë ushqimore (HACCP);

Shpenzimet administrative nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme.

## 4. LIDHJA ME MASAT E TJERA TË PROGRAMIT

Masa është e lidhur me masën 101 "Investimet në asetet fizike të fermave bujqësore" e cila siguron ofrimin e lëndëve të para.

Masa është e lidhur edhe me masën 302 "Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale", e cila ofron mbështetje në përpunimin e produkteve bujqësore në fermë që janë jo të pranueshme nën masën 103.

Deri më tani një mbështetje e konsiderueshme është ofruar përmes skemave kombëtare dhe skemave të granteve të IPA/BE-së për industrinë e përpunimit. Zbatimi i masës do të koordinohet me burime të tjera të mbështetjes dhe kritere të forta të demarkacionit do të krijohen gjatë programimit dhe zbatimit të PZHRB.

## 5. PËRFITUESIT FINAL



Përfitues mund të jenë personat fizik ose persona juridik dhe kooperativat e fermerëve. Ndërmarrjet e përpunimit të qumështit, mishit, frutave dhe perimeve si dhe sektori i prodhimit të verës, duhet të jenë të regjistruara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe janë përgjegjës për implementimin e projekteve të tyre. Një ndërmarrje mund të përbëhet nga një ose më shumë objekte (njësi lokale të prodhimit).

## 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

### 6.1 Për përfituesit

#### 6.1.1 Llojet e ndërmarrjeve të përkrahura

Mund të përkrahen vetëm ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (të përcaktuara në bazë të Rekomandimit të Komisionit 2003/361/EC). Kategoria e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është e përbërë prej ndërmarrjeve që punësojnë më pak se 250 persona, dhe që kanë një qarkullim vjetor që nuk i kalon 50 milion euro, dhe /ose bilanci i gjendjes në total që nuk i kalon 43 milionë euro, dhe të jetë i regjistruar sipas legjislacionit kombëtar si përpunues i ushqimit

#### 6.1.2 Qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes

Përfituesi do të paraqesë një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencioni i Pagesave . Në rastin e ndërtimit ose rindërtimit, dokumentacioni teknik i planit të ndërtimit ose rindërtimit duhet të përgatitet dhe të dorëzohet së bashku me Planin e Biznesit. Përfituesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit . Qëndrueshmëria ekonomike është definuar si shfrytëzim i plotë i burimeve të ndërmarrjes në një shkallë optimale dhe aftësinë për të vepruar pa mbështetje financiare publike. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund të kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes.

Modeli për planin e biznesit dhe udhëzimet për përgatitjen e tij do të jenë pjesë e formularit të aplikimit, të publikuar në faqen e internetit të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencioni i Pagesave dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë përfituesit potencialë.

#### 6.1.3 Standardet kombëtare

E tërë ndërmarrja e përfituesit duhet të përputhet me standardet minimale kombëtare relevante në fuqi në fund të implementimit të projektit ( përpara pagesës përfundimtare). Listë e plotë dhe e azhurnuar/ përditësuar e këtyre standardeve kryesore relevante kombëtare duhet të publikohet në faqen e internetit të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencioni i Pagesave dhe si shtojcë në udhëzuesin për aplikant.

#### 6.1.4 Kriteret e tjera të pranueshme për përfituesit

Në rastin e projekteve të ndërtimit , aplikantët e përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës me Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të dorëzojnë:

- Kopjen e skicave dhe një parallogaritje të shpenzimeve të punëve të parapara.;
- Pëlqimin e komunitetit

**Kurse, para kërkesës për pagesë ne Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të dorëzojnë:**

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i komunës,
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj
- Përfituesi duhet të dëshmojë se nuk ka taksa ose sigurime shoqërore të papaguara dhe çdo detyrim tjetër ndaj shtetit në kohën e paraqitjes së kërkesës.
- Përfituesit nuk mund ti ipet një projekt i ri para përfundimit dhe pagesës së projektit të mëparshëm.

#### 6.1.5 Kriteret e pranueshme për investime

- Investimet e mbështetura duhet të kenë të bëjnë me sektorin e përpunimit ose tregtimit të produkteve të qumështit dhe mishit , frutave, perimeve dhe verës të përfshira nga
- Shpenzimet e pranueshme të marketingut per te gjitha nën-masat e masës 103 janë:
- Përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosje, broshura, postera etj. për promovim të produkteve si rezultat i përkrahjes publike, por jo distribuimi i tyre.
- Prodhimi audio dhe video spoteve promovuese, por jo distribuimi i tyre medial.
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar ne 10% te investimeve në objekte, makineri dhe pajisje.
- Investimet ne nivel të shitjes me pakice nuk janë të pranueshme.
- Pajisjet e bashkë-financuara duhet të vijnë nga MS (VA), vende përfituese të IPA-s , anëtarët e Zonës Ekonomike Evropiane , vendet përfituese nga " Fqinjësia Evropiane dhe Instrumenti për Partneritet " apo vende të tjera ku qasja reciproke për ndihmën e tyre të jashtme ka qenë e vendosura nga Komisioni për investime.

## 7. KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË

### *SEKTORËT E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT DHE MISHIT*

Të kualifikuar janë përfituesit të cilët kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet përpara datës së aplikimit dhe janë të regjistruar me Agjencionin Kosovar të Ushqimit dhe Veterinarisë , sipas kategorizimit të ndërmarrjeve për përpunim të ushqimit.

- Kategoria "A" = shkallë e vogël e rrezikut
- Kategoria "B" dhe "C" = shkalla e dytë dhe e tretë e rrezikut
- Kategoria "D" = shkallë e lartë e rrezikut

Përfituesit e Kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të rindërtimit për shkak të mbylljes së ndërmarrjes së vjetër

### *SEKTORËT E PËRPUNIMIT TE PEMEVE DHE PERIMEVE*



Të kualifikuar janë përfituesit të cilët kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet përpara datës së aplikimit  
Në rast të investimit në qendrat grumbulluese dhe paketuese: kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jete prej 1,000 ton të prodhimit.

#### SEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

Të kualifikuar janë përfituesit e regjistruar në Regjistrin e Verërave të Kosovës. Për projekte fillestare/startuese përfituesit duhet të jenë të regjistruar në këtë Regjistër përpara pagesës përfundimtare nga Agjencia IPARD . Përfituesi duhet të ketë së paku 4. ha/ vreshta.

Përfituesi duhet të përpunojë rrushin e fermerëve të tjerë më shumë se 50% të prodhimit te vet.

Përfituesi nuk mund të ketë më shumë se 30 ha vreshta.

#### 8. SHPENZIMET E PRANUESHME

Investimet e pranueshme do të kufizohen në:

- Ndërtimin ose përmirësimin e pasurisë së paluajtshme (p.sh. blerja e pronës është e përjashtuar ) .
- Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja , duke përfshirë programe kompjuterike deri në vlerën e tregut të asetit .

Shpenzimet e përgjithshme të lidhura me investimet e shpenzimeve, të tilla si shpenzimet për arkitekt , inxhinierë dhe tarifat tjera konsultative, studime parapake, duhet të jenë të pranueshme deri në 10 % të shpenzimeve të investimeve, kurse shpenzimet administrative (p.sh përgatitja e projektit propozimit, plani i biznesit, nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante) nuk duhet të kalojë 3 % të kostos së investimit;

- Kostot e përgjithshme edhe pse në mënyrë retroaktive (pasi që ato mund të bëhen edhe para përfundimit të kontratës ) mund të konsiderohen si të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është zgjedhur dhe kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

**Shpenzimet maksimale për projekte do të jenë siç vijon:**

- Përpunimi i qumështit - 400,000 €, por jo më shumë se 200,000 € si përkrahje publike
- Përpunimi i mishit - 400,000 €, por jo më shumë se 200,000 € si përkrahje publike
- Pemët dhe perimet - 400,000 €, por jo më shumë se 200,000 € si përkrahje publike.
- Verëri - EUR 300,000, por jo më shumë se 150,000 € si përkrahje publike
- Shpenzimet minimale të investimit për projekt do të jenë 30,000 EURO

## 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Shënim: Kriteret e propozuara për përzgjedhje janë në nivel të masës. Tërësia e kriterëve për nivel të nën-masave mund të përdoret po ashtu.

### SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMËSHITIT

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investime në kategoritë B, C dhe D të përpunimit të qumështit me qëllim të plotësimit të të gjitha standardeve kombëtare veterinarë për të gjithë ndërmarrjen	35
2.	Investime që shprien në diversifikimin e prodhimit nga - Futja e të paktën 2 produkteve të reja ose - Me futjen e një linjë të përpunimit të qumështit të ripërtpësve të vegjël	20
3.	Kapaciteti i përpunimit të aplikantit është <30 ton / ditë	10
4.	Aplikuesi me të paktën 80% të qumështit të mbledhur është nga prodhimi kombëtar dhe në bazë të kontratave me fermerët	10
5.	Zbatimi i sistemeve të EU-së për siguri ushqimore (HACCP)	5
6.	Përvoja e ndërmarrjes në treg, më shumë se 3 vjet përvojë është e nevojshme.	5
7.	Investimet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit - Investimi është bërë për trajtimin e mbeturinave dhe pastrimin e ujit	5
8.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i referohet: Përmirësimit të efikasitetit të energjisë/ prodhimi i energjisë së rinovueshme/	5
9.	Vendet e reja të punës të krijuara	5
Totali		100

Në rast të pikëve të barabarta, hierarkia e projekteve përcaktohet drejtpërdrejt në bazë të shumës së shpenzimeve të pranueshme që drejtpërdrejt ndahen për investimet e përmendura nën kriterin e përzgjedhjes Nr. 1. Nëse prap pikët janë të barabarta, për përcaktimin e hierarkisë do të shqyrtohet kriteri i ardhshëm i përzgjedhjes.

### SEKTORI I PËRPUNIMIT TË MISHIT

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
-----	-------------------------	-------



1.	Për therrtoret dhe përpunuesit e tjerë të mishit	Investimet në therrtoret ekzistuese B, C dhe D në lidhje me sigurinë e ushqimit, mirëqenien e kafshëve dhe mjedisit synojnë në plotësimin e të gjitha standardeve kombëtare	20
2.		Investimet në thertore për vlerën e shtuar nga-produktet (të paktën 1 ekstraproduct i ri do të prodhohet) ose futjen e linjave të specializuara për therjen e ripërtypseve të vegjël	15
3.		Investime në ndërrmarjet e tjera të përpunimit të mishit B, C dhe D në lidhje me sigurinë e ushqimit, mirëqenien e kafshëve dhe standardevetë mjedisit që synojnë përmbushjen e të gjitha standardeve kombëtare	15
4.		Investime në ndërrmarje të tjera të përpunimit të mishit shpien në diversifikimin e prodhimit ose për të rritur kapacitetin e prodhimit të njësive me <15 ton në ditë	15
5.	Aplikuesi me të paktën 30% të mishit të përdorur është nga prodhimi kombëtar dhe në bazë të kontratave me fermerët		10
6.	Implementimi i standardeve të EU-së për sigurinë e ushqimit(HACCP)		5
7.	Investimet për mbrojtjen e mjedisit që kanë të bëjnë - Investime për trajtimin e mbetjeve dhe pastrimin / trajtimin e ujit		5
8.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i referohet: Përmirësimit të eficiencës së energjisë/ prodhimi i energjisë së rinovueshme/		5
9.	Përvoja e ndërmarrjes në treg, më shumë se 3 vjet përvojë është e nevojshme		5
10.	Vendet e reja të punës të krijuara		5
Totali			100

Në rast të pikëve të barabarta, hierarkia e projekteve përcaktohet drejtpërdrejt në bazë të shumës së shpenzimeve të pranueshme që drejtpërdrejt ndahen për investimet e përmendura nën kriterin e përzgjedhjes Nr. 1. Nëse prapë pikët janë të barabarta, për përcaktimin e hierarkisë do të shqyrtohet kriteri i ardhshëm i përzgjedhjes.

#### SEKTORI I PËRPUNIMIT TË FRUTAVE DHE PERIMEVE

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investime për qendrat e magazinimit: ndërtimi i qendrave të reja / rehabilitimit / zgjerimit të qendrave ekzistuese, duke përfshirë pajisje të ftohjes dhe të ngrirjes, mbështetje për klasifikim / gradim / paketim -linja të mbushjes / etiketimin. Kapaciteti minimal i magazinimit duhet të jetë 1,000 ton.	35
2.	Diversifikimi i prodhimit - futjen e linjave të reja të përpunimit për produkte të reja në nivelin e ndërmarrjes.	35
3.	Përvoja e ndërmarrjes në treg,	5

	më shumë se 3 vjet përvojë është e nevojshme		
4.	Marrëdhëniet kontraktuese: Së paku 80 % e prodhimeve të mbledhura duhet të vijnë nga prodhimet kombëtare dhe të kenë marrëdhënie kontraktuese me fermerët		5
5.	Zbatimi i sistemeve të BE-së për siguri ushqimore (HACCP) dhe / ose sistemet e menaxhimit të cilësisë të BE-së (GAP, ISO)		5
6.	Mbrojtja e mjedisit në lidhje me investimet . Të paktën 5% prej secilit nga investimet e pranueshme i referohet:	Përmirësimin e efikasitetit të energjisë/ prodhimi i energjisë së rinovueshme/	5
		Ruajtjen e mbeturinave / trajtimin e mbeturinave	5
7.	Vendet e reja të punës të krijuara		5
Totali			100

Në rast të pikëve të barabarta, hierarkia e projekteve përcaktohet drejtpërdrejt në bazë të shumës së shpenzimeve të pranueshme që drejtpërdrejt ndahen për investimet e përmendura nën kriterin e përzgjedhjes Nr. 1. Nëse prap pikët janë të barabarta, për përcaktimin e hierarkisë do të shqyrtohet kriteri i ardhshëm i përzgjedhjes

#### SEKTORI I PËRPUNIMIT TË VERËS

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në –"vijat e prodhimit" për verën në shishe	30
2.	Investimet për objektet ose pajisjet e ruajtjes	25
3.	Marrëdhëniet kontraktuese: Së paku 80 % e prodhimeve të mbledhura duhet të vijnë nga prodhimet kombëtare dhe të kenë marrëdhënie kontraktuese me fermerët	15
4.	Rritja e pjesëmarrjes së "verës me cilësi": Shpjegim i mjaftueshëm në formën e aplikimit në lidhje me kompetencën nga ana e përfituesit dhe treguesve lidhur me përmirësimin e qëllimshëm të cilësisë së verës	10
5.	Implementimii menaxhimit të cilësisë dhe / ose sistemet e sigurisë së ushqimit(ISO, HACCP,...)	5
6.	Mbrojtja e mjedisit me investimet e lidhura - të paktën 10% nga investimet e përgjithshme të pranueshme kanë të bëjnë me: përmirësimin e efikasitetit të energjisë / energjinë e rinovueshme / ruajtjen e mbeturinave/ trajtimin e mbeturinave dhe pastrimin e ujit	5
7.	Përvoja e ndërrmarjes në (mbajtjen e ferma ve) në treg për më shumë se 3 vite	5
8.	Vendet e reja të punës të krijuara	5
Totali		100

#### 10. INTENSITETI I NDIHMËS/SHKALLA E PËRKRAHJES



- Shpenzimet e përgjithshme publike do të jenë 50% e totalit të shpenzimeve të pranueshme.
- Një shtesë prej 10% do të jepet për investimet lidhur me trajtimin e mbetjeve, në 60% total.

## 11. BUXHETI

Buxheti indikativ sipas sektorëve është siç vijon me poshtë \*\* :

Sektorët	Vlera ne euro	% e buxhetit
Qumështi	1,000,000	33%
Mishi	1,000,000	33%
Pemët dhe perimet	700,000	23%
Vera	300,000	11%
Totali	3,000,000	100%

\*\*\*) Buxheti për verë është i paraqitur ndaras

## 11. TREGUESIT DHE QËLLIMET QË DUHET TË VENDUSEN NË PROGRAM

- Numri i vendeve të punës të krijuara (bruto)
- Objektivat e përcaktimit sasior për treguesit e përbashkët të BE-së

Lloji i treguesve	Treguesit	Qëllimi 2014	
INPUTET	Totali	€ 3,000,000	
	103.1 Përpunimi i qumështit	€ 1,000,000	
	103.2 Përpunimi i mishit	€ 1,000,000	
	103.3 Përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)	€ 1,000,000	
	Nga e cila	103.3.1 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	€ 700,000
		103.3.2 prodhimi i verës	€ 300,000
OUTPUTET	Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të përkrahura	21	
	103.1 Përpunimi i qumështit	6	
	103.2 përpunimi i mishit	6	
	103.3 përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)	9	
	Nga e cila	103.3.1 Përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)	6
		103.3.2 prodhimi i verës	3
	<b>Vëllimi i përgjithshëm i investimeve</b>		€ 5,810,377
	Nga e cila	Ne kapitalin fizik	€ 5,548,910
		Ne marketing	€ 261,467
	103.1 Përpunimi i qumështit		€ 1,936,792
	103.2 Përpunimi i mishit		€ 1,936,792
	103.3 Përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)		€ 1,936,792
	Nga e cila	103.3.1 përpunimi i pemëve dhe perimeve	€ 1,355,755

	103.3.2 Verërat	€ 581,038
REZULTATET	Numri i ndërmarrjeve me standarde të përmirësuara ne përputhje me standardet kombëtare dhe te BE ne sigurinë e ushqimit/ mirëqenien e kafshëve/ mjedisit	20
	Numri i ndërmarrjeve të modernizuara duke përfshir prodhime te reja dhe/ose teknika te reja te prodhimit	11
	Numri i ndërmarrjeve me marketing te përmirësuar	14
	Numri i konsoliduar i fermerëve në bazë të marrëdhënjeve kontraktuale	13
	Numri i ndërmarrjeve qe përfshijnë dhe përmirësojnë trajtimin e mbeturinave dhe menaxhimin e tyre	2
	Numri i ndërmarrjeve qe prodhojnë energji te ripertritshme	2
**NDIKIMI	***Rritja ekonomike - si shtesë neto e vlerës bruto te shtuar ne ndërmarrjet e mbështetura	15.00%
	Krijimi i vendeve te punës - nga numri i përgjithshëm bruto si shtesë e Kohës se Plot Ekuivalente (KPE) e krijimit te vendeve te punës ne ndërmarrjet e mbështetura.	60
	***produktiviteti i punës si ndryshim - Bruto Vlera e Shtuar BVSH për KPE të punës ne ndërmarrjet e mbështetura.	15.00%

1) Më 2014 fillojme me projektet e vogla

2) Pas 2014 "shpenzimi maksimal i investimit" duhet të rritet për së paku vlerën mesatare te volumit te investimet në 600.000 Euro

### 13.PROCEDURA ADMINISTRATIVE

Projektet do të përzgjidhen nga Agjencia për zhvillimin e Bujqësisë / Agjencioni i Pagesave në bazë të pranueshmërisë dhe kritereve të përzgjedhjes.

### 14.SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS

Gjithë territori i Republikës së Kosovës.



## M302: DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

### 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 03/L-098 Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 1 korrik 2009;
- Ligji Nr. 03/L-016 Për Ushqim, dt. 06 mars 2009;
- Ligji Nr. 03/L-029 Për inspektionin e bujqësorë, dt. 13 dhjetor 2008;
- Ligji Kosovë Nr. 02/L-122 Për Bujqësinë Organike në Kosovë, dt. 8 janar 2008;
- Ligji Nr. 02/L-111 Për bletarinë, dt. 8 shkurt 2008 ;
- Ligji Nr. 2005/47 Për verërat, dt. 14 tetor 2005;
- Ligji Nr. 2004/21 Për Veterinarinë, dt. 30 korrik 2004;
- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorin, dt. 14 tetor 2004;
- Ligji Nr. 2003/3 Për pyjet e Kosovës, dt. 20 mars 2003;
- Ligji Nr. 03-L-025 për mbrojtjen e mjedisit, dt. 19.03.2009;
- Ligji Nr. 04/L-074 Për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim Rural, dt. 19 Mars 2012.

### 2. ARSYESHMËRIA

Viset rurale kanë një rëndësi shumë-funksionale për zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe paraqesin një potencial të madh për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, potencial të madh për krijimin e vendeve të punës dhe krijimin e të hyrave.

Ekonomia e Kosovës vuan nga shkalla shumë e lartë e papunësisë. Rreth 45% e fuqisë punëtore është e papunë; kryesisht janë gratë dhe shumë nga të rinjtë. Problemet rezultojnë me zvogëlimin e atraktivitetit të viseve rurale si vende për të jetuar dhe punuar si dhe shtimin e dallimeve ndërmjet pjesëve urbane dhe rurale të vendit. Me rënien e cilësisë së jetesës dhe mundësive për të punuar, viset rurale kanë përjetuar një rënie ekonomike dhe mundësi të zvogëluar për punësim të popullsisë rurale në zona rurale.

Ndërhyrjet në kuadër të masës synojnë përmirësimin e mundësive për punë në viset rurale të Kosovës. Ato trajtojnë problemet kryesore të identifikuar të viseve rurale, që janë:

- Mungesa e mundësive për vende të punës për shkak të nismave të dobëta të zhvillimit ekonomik;
- Emigrimi, sidomos i rinisë nga viset rurale;
- Varësia e lartë nga punësimi në bujqësi;
- Mungesa e shërbimeve në viset rurale

Masa do të synojë krijimin e vendeve të reja të punës dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese. Përkrahja e aktiviteteve të reja ekonomike duhet të shpijë në uljen e varfërisë në viset rurale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Në pajtim me përfundimet e analizës sektoriale për diversifikimin e ekonomisë rurale në Kosovë, diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në viset rurale parashihet si perspektivë afatgjate për zhvillimin e ekonomisë rurale dhe një mënyrë e përshtatshme për krijimin e punësimit të vetëqëndrueshëm në viset rurale.

Vlera e shtuar e kësaj mase mund të shtohet fuqishëm nëse veprimet dhe/ose aktivitetet e pranueshme përbëjnë pjesë të strategjisë zhvillimore lokale specifike për viset rurale në fjalë që aktualisht nuk janë në dispozicion. Pas fillimit të masës “Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale” nënmasat për turizëm rural dhe shërbime të makinerisë bujqësore do të përqëndrohen fuqishëm në përzgjedhjen e projekteve të rekomanduara nga GLV-të për territoret përkatëse.

Në kuadër të masës, përparësi i jepet projekteve të realizuara në viset malore, të propozuara nga ndërmarrëset femra dhe fermerët e rinj. Prioritet i lartë gjithashtu i jepet projekteve për krijimin e vendeve të punës. Për turizmin rural dhe shërbimet e makinerisë bujqësore prioritet shtesë do tu jepet projekteve të rekomanduara nga GLV-të. Zbatimi i masës do të fillojë me zbatimin e nën-masës

#### 302.1 BLETARIA DHE PRODHIMI/PËRPUNIMI DHE TREGTIMI I MJALTIT

#### 302.2 PËRPUNIMI I BARISHTEVE, BIMËVE MJEKUESE, FRUTAVE PYJORE DHE TË GRUMBULLUARA

#### 302.3 PËRPUNIMI NË FERMË DHE TREGTIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE NË SHKALLË TË ULËT

Zbatimi i nën-masës 302.4 “Turizmi rural” do të shtyhet pas vitit 2014. Për zbatimin e nën-masës 302.5 “Ofrimi i shërbimeve të makinerisë” do të bëhet një studim preliminar i fizibilitetit i cili do të ofrojë bazën solide mbi të cilën nën-masa do të mund të zbatohet me sukses brenda kontekstit të Kosovës. Studimi do të shpijë në identifikimin e përfituesve potencial dhe llojin e investimeve të pranueshme. Veç kësaj, studimi do të specifikojë klauzolat e zotimit dhe mekanizmat e kontrollit që të lidhnin përfituesit me përdorimin e pajisjeve për qëllimin për të cilin ofrohet përkrahja.

### 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Sigurimi i punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mirëmbajtja e vendeve të punës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të biznesit, duke ngritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik të viseve rurale dhe duke ja ndërruar kahjen shpopullimit rural.
- Të kontribuojë në rritjen, punësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në viset rurale dhe kështu edhe në balancë më të mirë territoriale, në aspektin ekonomik dhe social, duke rritur drejtpërdrejt të hyrat e familjeve.

#### 3.1 Objektivat specifike

Krijimi, diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve rurale, përmes përkrahjes së investimeve për diversifikim të fermave dhe zhvillimin e aktiviteteve jobujqësore.

Masa ndahet në tri nën-masa:

302 Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit

303 Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara

304 Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, këpurdhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive)



#### 4. LIDHJA ME MASAT TJERA

Kjo masë është në bashkëpunim të ngushtë me qasjen Leader. Përmes kësaj, popullsia lokale dhe struktura e tyre organizative do të përfshihet herët në fillimin e strategjisë zhvillimore lokale duke identifikuar aktivitetet që duhet të bëhen të pranueshme për rajonin e tyre specifik në kuadër të kësaj mase. Masa është e lidhur me Masën 101 "Investimet në mjetet fizike të ekonomive bujqësore/fermave" dhe masën 103 "Investimet në asetet fizike për tregtimin dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe të peshkatarisë". Nevojat për trajnim dhe nevojat për shërbime këshillimore të identifikuar nën këtë masë do të përkrahjet nga veprimet në kuadër të masave "Përmirësimi i trajnimeve" dhe "Shërbimet këshillimore".

#### 5. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

Përfituesit përfundimtarë në kuadër të kësaj mase për nënmasat janë:

##### 302.1 Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit:

- Fermeret sipas përkufizimit në Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Nr. 03/L-098) të regjistruar në Regjistrin e Fermave.

##### 302.2 Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara:

- Fermeret sipas përkufizimit në Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Nr. 03/L-098) të regjistruar në Regjistrin e Fermave.
- Personat fizik dhe juridik sipas përkufizimit të ndërmarrjeve të vogla (që punësojnë deri në 9 veta dhe që gjatë 12 muajve të fundit kanë pasur një qarkullim të përgjithshëm prej 500,000 EUR ose më pak) sipas përkufizimit në Ligjin për Përkrahje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Nr. 02/L-5), që veprojnë në sektorin jobujqësor në viset rurale, të regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës. Personat fizik dhe entitetet ligjore të themeluara jashtë viseve rurale janë gjithashtu të pranueshme nëse investimet e propozuara ndodhen në viset rurale malore.

##### 302.3 Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive)

- Fermeret sipas përkufizimit në Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Nr. 03/L-098) të regjistruar në Regjistrin e Fermave.

#### 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

- Projektet do të jenë në përputhje me standardet relevante kombëtare në fund të zbatimit të projektit.
- Shkathësitë për punë – përfituesi duhet të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar në sektorët e veçantë (shih seksionin për kriteret specifike të pranueshmërisë).
- Aplikanti duhet të demonstrojë në planin e biznesit që investimi do të jetë ekonomikisht rentabil në fund të realizimit të projektit – rentabiliteti ekonomik nënkupton që aplikanti mund të kryejë obligimet e borxheve të veta pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes së vet dhe rrjedha e parasë është tërë kohën pozitive:

- Për investimet ku shpenzimet e përgjithshme të pranueshme janë të barabarta ose nën 20,000 EUR, rentabiliteti ekonomik duhet paraqitur i sqaruar në projekt propozimin teknik;
- Për investimet ku shpenzimet e përgjithshme të pranueshme mbi 20,000 EUR, rentabiliteti ekonomik duhet demonstruar përmes planit të biznesit.
- Modeli i projekt propozimit teknik dhe modeli i planit të biznesit me udhëzime të hollësishme rreth përgatitjes do të publikohet në uebfaqen e AZhB-së dhe do të vihet në dispozicion për të gjithë përfituesit potencial si pjesë e formularit të aplikacionit.
- Në rast të projekteve të ndërtimit dhe/ose rindërtimit aplikanti duhet të dorëzojë kopjet e skicave të miratuara teknike dhe vlerësimin e shpenzimeve për punët e papaparapara.
- Në rast të projekteve të ndërtimit dhe/ose renovimit, para nënshkrimit të kontratës me AZhB-në, përfituesit potencial duhet të dorëzojnë:
  - Lejen ndërtimore nga komuna
  - Vlerësimi i ndikimit në mjedis, nëse është i obligueshëm me ligj.
- Aplikanti duhet të demonstrojnë vazhdimësinë e operacioneve gjatë së paku pesë viteve pas realizimit të investimit.
- Aplikanti nuk duhet të ketë detyrime të pashlyera ndaj shtetit sa i përket obligimeve fiskale dhe obligimeve financiare ndaj fondit shëndetësor, social dhe sigurimit pensional.
- Aplikanti duhet të dëshmojë që ai/ajo është pronar i tokës ose objekt/eve ndërtimore ose që ka kontratë qiraje apo koncesioni për së paku 5 vite në rast të investimeve, që nuk nënkuptojnë punë ndërtimore.
- Në rast të investimeve në punë ndërtimore, aplikanti duhet të dëshmojë të drejtë e shfrytëzimi të tokës/objektit ndërtimor për së paku 10 vite apo të dëshmojë pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit për qëllime ndërtimi për së paku 10 vite.

## 7. KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË,

### 7.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë për nënmasën 302.1: (Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit)

Aplikantët duhet:

- të kenë së paku 50 koshere dhe më së shumti 500 koshere.
- të dëshmojnë përvojë të mjaftueshme bujqësore dhe kompetencë në njërën nga kategoritë në vijim:
  - sepaku shkollimin e mesëm dhe një deklaratë me shkrim ku zotohen që do të vijojnë një kurs trajnimi me kohëzgjatje prej së paku 150 orë mësimore para aplikimit për pagesë përfundimtare
  - shkollim të mesëm bujqësor



- së paku dy vite përvojë bujqësore (qoftë nga shënimet e shërbimit profesional për përvojën e punës në bujqësi në specializimin relevant ose nga regjistrimi për atë kohë në Regjistrin e Fermave)
  - Të dëshmojë që standardet minimale kombëtare për sektorin e bletarisë janë arritur në fund të investimit – të paraqesë me kërkesën për pagesë në AZhB, një certifikatë nga AVU dhe Autoritetet Mjedisore (nëse janë të aplikuashme)
- 7.2 Kriteret specifike të pranueshmërisë për nënmasën 302.2 – Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara**
- Aplikantët janë të licencuar për grumbullimin e barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave nga Autoriteti Kombëtar i Pyjeve
  - Të dëshmojë që standardet minimale kombëtare për përpunim të ushqimit janë arritur në fund të investimit – të paraqesë me kërkesën për pagesë në AZhB, një certifikatë nga AVU dhe Autoritetet Mjedisore
- 7.3 Nën-masa 302.3 - Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive)**

*Kriteret specifike të pranueshmërisë për nënmasën 302.3:*

*Në rast të investimeve në përpunim, aplikanti duhet të:*

- demonstroj në projekt propozimin teknik që së paku 50% e lëndës së parë të përpunuar është e prodhuar në fermën e përfituesit
- të dëshmojë që standardet minimale kombëtare për përpunimin e ushqimit janë arritur në fund të investimit – të paraqesë me kërkesën për pagesë në AP, një certifikatë nga AVU dhe Autoritetet Mjedisore
- në rastin e përpunimit të deleve dhe dhive të ketë së paku 50 dele ose 30 dhi.

## **8. SHPENZIMET E PRANUESHME NËN KËTË MASË**

### **8.1 Investimet e pranueshme për nën-masën 302.1:**

- Investimet në koshere, në prodhim të mjaltit dhe në makineri dhe pajisje për përpunim.
- Rimorkiot e specializuara për bartjen e koshereve përfshihen vetëm kur janë mbi 100 koshere.
- Investimet në prodhim/përpunim, përfshirë
  - Ndërtimi dhe pajimi i objekteve për ruajtje dhe përpunim
  - Blerja e pajisjeve për mjaltë dhe laboratorëve për analizim të produkteve të bletëve
  - Blerja e linjave teknologjike për përpunim të mjaltit dhe paketim
  - Themelimi dhe pajisja e stacioneve për mbarështim

- Renovimi dhe blerja e pajisjeve relevante
- Investimet për tregtimin e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, për nisma të prodhuesve)

Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit,

kurse shpenzimet administrative (p.sh përgatitja e projektit propozimit, plani i biznesit, nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante) nuk duhet të kalojë 3 % të kostos së investimit

### *8.2 Investimet e pranueshme për nënmasën 302.2*

- Ndërtimi/renovimi i objekteve për ruajtjen, paketimin dhe përpunimin e barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
- Blerja e pajisjeve për ruajtje, paketim dhe përpunim
- Investimet për tregtimin e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, për nisma të prodhuesve)

Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketingut nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit,

kurse shpenzimet administrative (p.sh përgatitja e projektit propozimit, plani i biznesit, nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante) nuk duhet të kalojë 3 % të kostos së investimit ;

### *8.3 Investimet e pranueshme indikative për nënmasën 302.3*

- Investimet në makina dhe pajisje përpunuese për pastrim, klasifikim, tharje, grumbullim, ruajtje (frigoriferë me ftohje, me ngrirje), paketim dhe etiketim;
- Investimet në pajisjet specifike për përpunim me theks në përmirësimin e higjienës dhe cilësisë së ushqimit;
  - Ndërtimi dhe renovimi i pronës së paluajtshme sa i përket objekteve për ruajtjen e prodhimeve të qumështit;
  - Ndërtimi dhe renovimi i pronës së paluajtshme sa i përket objekteve për aktivitetet e pas-vjeljes
  - Renovimi i enterierit ose konvertimi i objekteve ekzistuese për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale;
  - Investimet për marketing e produkteve të prodhuara dhe përpunuara (materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në panairët lokale/kombëtare, për nisma të prodhuesve)

Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketingut nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit, kurse ,



shpenzimet administrative (p.sh përgatitja e projektit propozimit, plani i biznesit, nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante) nuk duhet të kalojë 3 % të kostos së investimit ;

*Shpenzimet minimale të investimeve të pranueshme për projekte në kuadër të kësaj mase do të jetë e kufizuar në:*

**Për nën-masën 302.1, 302.2 dhe 302.3:**

- Shpenzimet minimale të investimeve të pranueshme për projekte në kuadër të kësaj mase do të jetë e kufizuar në: 3,000 EUR
- Shpenzimet maksimale të investimeve të pranueshme për projekte në kuadër të kësaj mase do të jetë e kufizuar në: 20,000 EUR

## 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES

### 9.1 Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën 302.1:

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët	
1	Madhësia e fermës	Nr. i koshereve		
			50-100	30
			101-300	20
		301-500	10	
2	Përvojë në bletari dhe prodhim të mjaltit	Vlera e prodhimit të dy viteve të fundit: 1,000- 3,000 EUR	20	
		> 3,000 EUR	15	
3	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalenteve me orar të plotë - POP )	Krijimi i mbi një POP <sup>1</sup> (në bazë të projekt propozimit teknik	15	
		Krijimi i 1 POP	10	
		Krijimi i 0.5 POP	5	
4	Vendndodhja	Ferma ndodhet në zonë malore	10	
5	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	10	
6	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	10	
7	Bujqësia organike e zhvilluar	Certifikuar për prodhim organik	3	
8	Të jetë antarë i shoqatës	Certifikata e antarsisë	2	
Totali maksimum			100	

### 9.2 Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën 302.2

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Përvoja në aktivitetin e grumbullimit	Vlera e prodhimit të dy viteve të fundit: 1,000- 3,000 EUR	35
		> 3,000 EUR	30
2	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalenteve me orar të plotë - POP )	Krijimi i mbi një POP (në bazë të projekt propozimit teknik	20
		Krijimi i 1 POP	15
		Krijimi i 0.5 POP	10

<sup>1</sup> POP – të punësuar me orar të plot

3	Vendndodhja e fermës/biznesit	Ferma ndodhet në zonë malore	15
4	Aspekti gjinor	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	10
5	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	10
6	Bujqësia organike e zhvilluar	Certifikuar për prodhim organik	10
Totali maksimum			100

### 9.3 Kriteret e përzgjedhjes për nën-masën 302.3:

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Disponueshmëria e strategjisë së marketingut për prodhim	Koncepti i hollësishëm i marketingut për prodhimin	25
2	Sigurimi i punësimit në viset rurale (krijimi i vendeve të punës matet me njësi të ekuivalenteve me orar të plotë - POP)	Krijimi i mbi një POP (në bazë të projekt propozimit teknik	20
		Krijimi i 1 POP	15
		Krijimi i 0.5 POP	10
3	Ngritja e standardeve të higjienës të përpunimi i ushqimit	Investimi synon përafrimin me standardet e së sigurisë së ushqimit, higjienës dhe/ose mjedisit	20
4	Sigurimi i ndërmarrësisë së grave	Investimi udhëhiqet nga gratë ndërmarrëse	15
5	Regjistrimi i fermës/biznesit	Ferma/aktiviteti ndodhet në zonë malore	10
6	Përmirësimi i strukturës së moshës në viset rurale	Ndërmarrësit e rinj nën 40 vjeç	10
Totali maksimum			100

## 8. SHKALLA E PËRKRAHJES

Shpenzimet publike nuk duhet të kalojnë 65% e të gjitha shpenzimeve të pranueshme të investimit.

## 9. BUXHETI INDIKATIV PËR NËN-MASË:

Ndarja indikative buxhetore ndërmjet sektorëve është siç vijon:

Nënmasa	Vlera në Euro	% e buxhetit
302.1 - Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	300,000	35 %
302.2 - 302.2 Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	250,000	30 %
302.3 - Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, fruta, barishte, erëza, bimë mjekuese, kërpudhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive)	300,000	35 %



Totali	850,000	100%
--------	---------	------

#### 10 TREGUESIT DHE PIKËSYNIMET

LLOJET E INDIKATOREVE	*Treguesit	Targeti 2014	
INPUTI	Totali	850,000	
	302.1 Bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	300,000	
	302.2 Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	250,000	
	302.3 Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët	300,000	
	302.4 Turizmi Rural	0	
	302.5 Sigurimi i shërbimeve të makinerisë për Fermeret	0	
OUTPUTI	Nr. i përgjithshëm i Projekteve të mbështetura		73
	Prej të cilëve	302.1. Mjalti	26
		302.2 Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	21
		303.3 Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët	26
	Vlera e përgjithshme e investimeve		1,350,192
	Prej të cilëve	302.1. Mjalti	476,538
		302.2 Përpunimi i barishteve, bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara	397,115
		303.3 Përpunimi në fermë dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët	476,538
			0
	REZULTATI	Numri i vendeve të reja të krijuara	63
Numri i fermave dhe i ndërmarrjeve që krijojnë burime tjera të ardhurave nga aktivitetet e diversifikimit.		54	
Numri i fermave apo ndërmarrjeve që kanë shtrirë aktivitetin e tyre në drejtim të përpunimit të vogël		38	
Numri i fermave apo ndërmarrjeve me aktivitetet e përmirsuara të marketingut		47	
IMPAKTI	Të ardhura shtesë (euro / vit) - si të ardhura të përgjithshme shtesë të krijuara në fermat e mbështetura ose ndërmarrjet	301,574	

#### **11 PROCEDURA ADMINISTRATIVE**

Masa do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencioni i Pagesave. Procedurat e hollësishme administrative do të paraqiten në udhëzimet për aplikant

#### **12 FUSHËVEPRIMI GJEOGRAFIK I MASËS**

Kjo masë është e pranueshme për përfituesit në viset rurale, siç përkufizohet në program.



# MASA: SKEMA NACIONALE E GRANTEVE PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

## 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 02/L-9 Për ujitjen e tokave bujqësore, dt. 25 nëntor 2005
- Ligji Nr. 02/L-26 Për tokën bujqësore, dt. 23 qershorë 2006
- Ligji Nr. 2004/24 Për ujërat e Kosovës, dt. 14 tetor 2004
- Ligji Nr. 03/L-024 Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, dt. 19 mars 2009
- Ligji Nr. 04/L-110 Për ndërtim, dt. 19 qershor 2012
- Ligji Nr. L-042 Për prokurimit publikë, dt. 31 gusht 2012
- Ligji Nr. 04/L040 Për rregullimin e tokës, dt. 22 shkurt 2012
- Ligji Nr. 04/L-074 Për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim Rural, dt. 19 Mars 2012.

## 2. ARSYESHMËRIA

Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme, një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës, nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes.

Derisa në stinët tjera të reshurat janë të mjaftueshme, ato mungojnë gjatë stinës së verës. Prandaj imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë. Pendat, rezervuarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat etj. kanë nevojë për rehabilitim, për ndertime të reja si dhe për mirëmbajtje të rregullt. Zhvillimi i bujqësisë intensive dhe konkurruese, në kushtet ekonomisë së tregut të lirë, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe ato që parashikohen.

## 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Rritja e produktivitetit
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore.

### 3.1 Objektivat specifike

- Modernizimi i sistemit për ujitje dhe drenazha duke zvogëluar humbjet në sasinë e ujit dhe përmirësimin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Përmirësimi i lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes.

## 4. LIDHJA ME MASAT E TJERA TË PËRFSHIRA NË PROGRAM

Masa ka lidhje në mbarëvajtjen e masës 101 për fermerët individual-investimet në ekonominë bujqësore.

## 5. PERFITUESIT

- Kompanitë e ujitjes ;
- Komuna;
- Shoqatat e përdorueseve të ujit.

## 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

- Projekti teknik i dorëzuar duhet të demonstrojë zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 10% në rast modernizimi.
- Përfituesit duhet të angazhohen që të mirëmbajnë ose të bëjnë riparimin e infrastrukturës bujqësore në mënyrë që të përfitojnë nga ndihma për të paktën 3 vjet pas zbatimit të projektit dhe të jetë nën kontrollin e Agjencionit të Pagesës dhe Departmentit të Ujitjes së MPBRZH. Nëse nuk është bërë mirëmbajtja gjatë kësaj periudhe atëherë përfituesi duhet të kthejë prapa investimin.
- Përfituesi duhet të kontraktojë ndërtuesin i cili ka përvojë të mëherëshme në ndërtimet relevante që kërkohen dhe i cili do të garantojë për punën e ndërtimit për së paku 3 vjet pas finalizimit të punës. Ndërtuesi i kontraktuar duhet të dëshmojë profitin e ndërmarrjes së tij për tre vitet e fundit dhe respektim të legjislacionit nacional të prokurimit.
- Përfituesi duhet të dorëzojë deklaratën me shkrim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit.
- Sipërfaqja minimale nën ujitje e projektit: 50 ha.
- Aplikuesit duhet të dëshmojë të drejtat pronësore lidhur me investimin e propozuar.
- Nje kompani e ujitjes mund të aplikojë maksimumi për 1 projekt për komunë.
- Aplikantët do të paraqesin vendimin pozitiv të Bordit/Kuvendit gjatë propozimit të investimit.
- Vlerësimi i projekteve dhe kontrollat në teren nga Agjencioni i Pagesës para dhe pas nënshkrimit të kontratës mund të bëhen edhe nga MPBRZH- ekspertët e ujitjes sipas kërkesës së Agjencionit për Zhvillim Rural të bartet të pjesa administrative.
- Kosto minimale e investimit të pranueshëm për projekt është: 15.000 €.

## 7. KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHME (PËR SEKTOR)

Nuk janë të aplikueshme.

## 8. INVESTIMET E PRANUESHME

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i kanaleve dhe gypave të ujitjes;
- Ndërtimi i rezervuarëve të ujit;
- Penda e ujitjes;
- Ndërtimi i drenazhës/kullimit;
- Pompat e ujitjes dhe pajisjet e tjera përcjellëse:(pajisje për matjen e ujit, për rrymë, etj;
- Rehabilitimi i pajisjeve (valvulat, lidhëset, gypat, përfshirë edhe punën)
- Punët përcjellëse me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, nivelimi i tokës, varësisht nga lloji i projektit).

Shpenzimet që janë të lidhura me përgatitjet projektit janë të pranueshme për përkrahje deri në 10% të shpenzimeve të pranueshme:



- Skicat/ dizajnimet e hollësishme të projektit inxhinierik
- Vlerësimi i ndikimit mjedisor
- Përgatitja e dokumenteve të aplikimit.

Shpenzimet e papranueshme janë:

- Shpenzime operationale të lidhura me heqjen (largimin e baltës nga pjese e sipërme e kanaleve);
- artikujt tashmë të financuar në kuadër të ndonjë kornize tjetër;
- blerja e tokës apo ndërtesave;
- zëvendësimet/renovimet e thjeshta të ndërtesave apo makinerisë;
- tatimet, përfshirë TVSH-në, përveç nëse përfituesi (apo partnerët e përfituesit) nuk mund t'i kthejnë ato dhe rregulloret e aplikueshme nuk ndalojnë mbulimin e tatimit;
- blerjet e pajisjeve të përdorura;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- kontributet në natyrë;
- shpenzimet e amortizimit (zhvlerësimit);
- shpenzimet operative;
- shpenzimet për doganim apo import, apo pagesa tjera

#### 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Kriteri	Parametri	Nr. i pikëve

<b>Kostot-efektive për zgjerimin e siperfaqeve të ujitura</b>	<p>Metoda e kalkulimit:</p> <p>Të gjitha projektet teknike duhet të përfshijnë të dhëna në lidhje me zonën që është rehabilituar/zgjerimi për ujitje dhe kostoja mesatare për ha. Pasi të janë vlerësuar të gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove/ha, duke filluar nga më e ulëta deri të më e larta. Projekti me koston më të ulët do të marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për hektar do të marrin 0 (zero) pikë. Pjesa tjetër e projekteve të pranueshme do të marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriter bazë të koston së tyre për ha, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë.</p> <p><b>Kalkulimi për poentim:</b></p> $30 * (C_p - \max C) / (\min C - \max C)$ <p>C<sub>p</sub> - kosto për 1 ekstra ose ha të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e vlerësuara</p> <p>Shpenzime minimale C kosto për 1 ekstra ha të modernizuar të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto minimale për ekstra ose ha të modernizuar të ujitur -</p> <p>Maksimale C- kosto për 1 ekstra ose modernizim ha të ujitur nga infrastruktura për ujitje për projektet e pranueshme me kosto maksimale për ekstra ose modernizim ha të ujitur</p>	<b>Max. 30</b>										
<b>Siperfaqja e ujitur (ha)</b>	<table border="1"> <tr> <td>50-75</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>75,01 - 100,00</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>100,01-150,00</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>150,01 - 200,00</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>Me shume se 200</td> <td>30</td> </tr> </table>	50-75	10	75,01 - 100,00	15	100,01-150,00	20	150,01 - 200,00	25	Me shume se 200	30	
50-75	10											
75,01 - 100,00	15											
100,01-150,00	20											
150,01 - 200,00	25											
Me shume se 200	30											
	<p>Së paku 50% e sipërfaqeve të ujitura/të modernizuara janë për hortikulturë (jo lavertare) në bazë të dhenave në regjistrin e fermës nga viti paraprak</p>	<b>10</b>										
	<p>Së paku 30% e sipërfaqeve të ujitura/të modernizuara janë për hortikulturë (jo lavertare) në bazë të dhënave në regjistrin e fermës nga viti paraprak</p>	<b>5</b>										
<b>Numri i fermerëve që përfitojnë nga</b>	<table border="1"> <tr> <td>Deri në 10</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>11-20</td> <td>15</td> </tr> </table>	Deri në 10	10	11-20	15							
Deri në 10	10											
11-20	15											



projekti	Më shumë se 20	20
Në fushën e projektit ka prodhues me projekte të miratuara nën masën 1 or 101	Deri në 5	5
	Më shumë se 5	
<b>Totali</b>		<b>100</b>

Sqarim: Sistemi i rangimit do të aplikohet për të gjitha aplikacionet e pranueshme.

#### 10. NIVELI I MBËSHTETJES DHE INTENZITETI I NDIHMËS PUBLIKE

Intensiteti i mbështetjes publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme.

Kosto maksimale e investimit të pranueshëm : 150.000 €.

#### 11. BUXHETI INDIKATIV

Mjetet financiare për këtë masë janë: 1,500,000Euro

#### 12. TREGUESIT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMI

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Të dhënat	1.500.000 euro	
Prodhimi	Vlera e përgjithshme e investimeve (euro)	1,875,000
	Numri i përfituesve të mbështetur	14
Rezultati	Sipërfaqet e zgjeruara të ujitura (ha)	1,050
	Sipërfaqet e modernizuara të ujitjes (ha)	1,050
	Rritja totale e prodhimit (në ton)nga sipërfaqet e ujitura si rezultat i drejtpërdrejtë i investimeve të propozuara, për:	
	Drithërat	1,890
	Perimet	5,880
	Pemet	8,820
	Rrushi	2,940
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (euro)	7,748,475

### 13. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit. Investimi duhet të bëhet në afat te percaktuar ne udhezuesin ditësh nga data e aprovimit të projektit. Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen përmes transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

Pagesat në dy pjesë janë të mundshme vetëm në rast se mbështetja publike është më e madhe se 50.000 euro dhe nëse kërkesa për pagesën e parë është së paku 30,000 euro mbështetje publike. Përveç kërkesës së rregullt për pagesën e parë është e mundshme edhe një paradhënie e pagesës sipas këtyre kushteve:

Paradhënia e pagesës deri në 80% të mbështetjes publike është e mundshme si kërkesë me shkrim vetëm për entitetet shtetërore (komunat dhe kompanitë publike) në rast të marrjes së vendimit pozitiv të Bordit/Kuvendit gjatë propozimit të investimit.

Paradhënia e pagesës mund të bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës me Agjencionin për Zhvillim Rural. Agjencioni për Zhvillim Rural duhet të zbris këtë avans të dhënë për pagesat e ardhshme sipas kontratës. Në rast se nuk dëshmohet për përdorimin e paradhënies së pagesës atëhere Agjencioni për Zhvillim Rural duhet ti ndjek për rrimarjen direkte të pagesës dhe në rast se nuk kthehen atëhere duhet të nxjerren në gjykatën kompetente për mashtrim të fondeve publike.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit me projekt propozimin, sipas formës standarde të MBPZHR-së;
- Kopja e një llogarie bankare të vlefshme;
- Kopja e letërnjoftimit të menaxherit dhe të personit të autorizuar (përfaqësues të biznesit);
- Deklarata e përfituesit për të bërë mirëmbajtjen e infrastruktures së mbështetur për të paktën 3 vjet dhe të jete nën kontrollin e Agjencionit për Zhvillim e Bujqësisë. Nëse kjo nuk ndodh atëherë përfituesi duhet të kthej mbështetjen financiare të pranuar mbrapa.
- 

**Pas përzgjedhjes së projektit, kërkohet:**

- Kopja mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor nga MMPH –të paraqitet para pagesës së 1-rë;
- Leja për ndërtim-të paraqitet para pagesës së 1-rë;
- Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë edhe dëshminë se është zhvilluar procedura e prokurimit.

### 14. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

Tërë territori i Republikës së Kosovës.



## SHTOJCA 1

### KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË PËR TË GJITHA MASAT E PBZHR-SË

1. Nëse aplikantët janë persona fizik ata duhet të jenë të moshës 18 deri 60 vjeç.
2. Aplikantët duhet të dorëzojnë formularin e aplikacionit bashkë me dokumentet që kërkohen në formularin e aplikacionit të siguruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.
3. Aplikanti duhet nënshkruaj një deklaratë me të cilën zotohet se nuk do ta ndryshoj destinimin e investimit për së paku pesë vite pas kryerjes së investimit.
4. Aplikantit nuk i lejohet të kenë borxhe të pashlyera ndaj shtetit (tatimi në pronë për personat fizik kurse për ndërmarrjet tatimet e shlyera në ATK) dhe nuk lejohet të kenë obligime ndaj MBPZHR, duke u bazuar në kontratë.
5. Pajisjet/mallrat që vijnë nga vendet e mëposhtme do të jenë të pranueshme për financim:
  - a) vendet anëtare të BE-së, vendet përfituese nga IPA, anëtarët e Zonës Ekonomike Evropiane dhe vendet partnere që përfitojnë nga "Instrumenti për Fqinjësi Evropiane dhe Partneritet" dhe
  - b) vendet donatore për të cilat është përcaktuar qasja e ndërsjellë për asistencë të jashtme sipas rregullores së IPA
  - c) Për mallrat dhe shërbimet me vlera më të vogla se 150 €, kërkohet dëshmia për origjinën në formë të deklaratës me shkrim nga aplikuesi apo një dokumenti të vlefshëm.
6. Një aplikues mund të aplikoj vetëm me një projekt (një nen- mase) brenda vitit
7. Te gjithë përfituesit duhet ti respektojnë rregullat e dukshmërisë / identitetit të financuesit-Qeverisë së Kosovës (udhëzimet me detale do të jenë në udhëzuesin për fermer).

### Shpenzimet e pranueshme

Shpenzime të pranueshme do të konsiderohen:

1. Ndërtimi ose riparimi i pronës së paluajtshme.
2. Blerja e makinave dhe pajisjeve të reja, përfshirë softuerët e kompjuterëve deri në vlerën e tregut të asetit.
3. Shpenzimet tjera të pranueshme të ndërlidhura me investimet siç janë: pagesat për arkitektë, inxhinierë si dhe pagesat për konsultime, për studime fizibiliteti, përvetësim i të drejtave patentore dhe licencave. Shuma maksimale e pranueshme për këto shpenzime nuk duhet të tejkalojë 12% të shpenzimeve për investimeve, prej të cilave shpenzimet për përgatitjen e projekt-propozimeve dhe planeve të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 3% të shpenzimeve për investime.

4. Shpenzimet e përgjithshme edhe pse të pranueshme në mënyre retroaktive (pasi që ato mund të ndodhin para nënshkrimit të kontratës) mund të konsiderohen të pranueshme vetëm nëse projekti me të cilin ndërlidhen, përzgjidhet dhe kontraktohet nga Agjencia për Zhvillim të Bujqësisë.

#### Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme

1. Shpenzimet e bëra para dorëzimit të aplikacionit;
2. Tatimi, përfshirë TVSH-në;
3. Taksat doganore dhe të importit ose ndalesat tjera;
4. Blerja, marrja me qira apo lizingu i tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
5. Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
6. Shpenzimet operative;
7. Pajisjet e dorës së dytë;
8. Ndalesat bankare, shpenzimet e garantimit dhe ndalesat e ngjashme;
9. Shpenzimet e konvertimit, ndalesat dhe humbjet nga ndërrimi i valutës;
10. Kontributet në mallra;
11. Blerja e të drejtave për prodhimtari bujqësore, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
12. Çfarëdo shpenzimi për mirëmbajtje, zhvlerësim apo qira;
13. Çfarëdo shpenzimi nga administrata publike në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës;
14. Shpenzimet lidhur me blerjen me lizing si marzha e dhënësit të lizingut, shpenzimet e rfinansimit të kamatës, shpenzimet e përgjithshme (*overheads*) dhe ato të sigurimit.
15. Shpenzimet e financuara nën PBZHR nuk do të jenë subjekt i ndonjë financimi të donatoreve tjerë dhe nga BE-ja.